



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

Monitorimi i Shpenzimeve **4-MUJORI** **2026**

PËR MINISTRINË E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT



Ekonomi. Inovacion.
Zhvillim i qëndrueshëm



DREJTORIA E BUXHETIT
DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

TIRANË, MAJ 2026

HYRJE.....	3
ANALIZË E PËRGJITHSHME	4
INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR.....	6
PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI.....	20
PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT	21
1. Performanca financiare e programit buxhetor	21
Programi-Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi	21
Programi-Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji.....	23
Programi-Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	24
Programi - Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale.....	28
Programi – Strehimi	32
Programi-Arsimi i Mesëm (profesional)	33
Programi -Tregu i Punës	36
Programi-Sigurimet shoqërore	38
2. Performanca jo-financiare e programit buxhetor.....	39
Programi -Tregu i Punës	39
Për programin - Sigurimet Shoqërore.....	41
Programi - Strehimi.....	42
Program - Arsimi i Mesëm Profesional.....	44
Program - Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	45
Programi - Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale”	48
Programi - Inspektimi në Punë.....	49
Programi - Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji.....	50
Programi - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	51
Te ardhurat jashtë limit kapitull 06.....	52
Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Inovacionit nëpër programet	53
Përfundimi dhe rekomandime.....	55
Tabelë 1 Struktura e shpenzimeve	5
Tabelë 2 Realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve buxhetore, 4-mujori 2026 në mijë lekë	6
Tabelë 3 Realizimi i shpenzimeve në %	6
Tabelë 4 Plani fillestar, plani i rishikuar, realizimi faktik dhe struktura e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, 4-mujori 2026	8
Tabelë 5 Ndryshimet e planit buxhetor sipas programeve, viti 2026 në mijë leke	9

Hyrje

Ky raport paraqet monitorimin e zbatimit të buxhetit për janar–prill 2026 për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, në përputhje me Udhëzimin nr. 14, datë 30.05.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, si dhe në funksion të fushave të përgjegjësisë së ministrisë, të përcaktuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 25.09.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”.

Raporti analizon performancën financiare të fondeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, sipas programeve buxhetore, klasifikimit ekonomik të shpenzimeve dhe burimeve të financimit, duke krahasuar planin vjetor fillestar, planin vjetor të rishikuar dhe shpenzimet faktike progresive për periudhën raportuese.

Për vitin 2026, buxheti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit administrohet në grupin buxhetor nr. 04 dhe mbulon programet buxhetore në fushën e administrimit institucional, inovacionit dhe teknologjisë, zhvillimit ekonomik, mbikëqyrjes së tregut dhe infrastrukturës së cilësisë, inspektimit në punë, strehimit, arsimit të mesëm profesional, sigurimeve shoqërore dhe tregut të punës.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2026 përfaqëson një proces të vazhdueshëm vlerësimi të performancës së fondeve publike, përmes krahasimit të treguesve faktikë me ato të planifikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm. Ky proces synon përmirësimin e planifikimit financiar, rritjen e eficiencës së përdorimit të fondeve dhe forcimin e lidhjes ndërmjet burimeve buxhetore dhe rezultateve të politikave publike. Fondet publike janë alokuar për nëntë programe buxhetore që mbështesin këto politika prioritare.

Ky raport ofron një pasqyrë të konsoliduar mbi realizimin e shpenzimeve buxhetore, devijimet nga plani dhe faktorët ndikues, duke shërbyer si instrument për transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të mëtijshëm të menaxhimit financiar publik. Vlerat e detajuara paraqiten në anekset bashkëlidhur.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit administron dhe menaxhon fondet publike sipas nëntë programeve buxhetore të miratuara, konkretisht:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”
2. Programi “Mbështetje për inovacion dhe teknologji”
3. Programi “Mbështetje për zhvillim ekonomik”
4. Programi “Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturën e cilësisë dhe pronësinë industriale”
5. Programi “Inspektimi në punë”
6. Programi “Strehimi”
7. Programi “Arsimi i mesëm profesional”
8. Programi “Sigurimet shoqërore”
9. Programi “Tregu i punës”

Për periudhën janar–prill 2026, realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas secilit program, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, paraqitet si më poshtë:

Nr	Emërtimi i Programit	Realizimi në % ndaj planit vjetor
1	Planifikim, menaxhim dhe administrimi	29.8%
2	Mbështetje për inovacion dhe teknologji	9.7%
3	Mbështetje për zhvillim ekonomik	22.4%
4	Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut dhe cilësinë	31.2%
5	Inspektimi në punë	27.4%
6	Strehimi	6.2%
7	Arsimi i mesëm profesional	20.0%
8	Sigurimet shoqërore	31.0%
9	Tregu i punës	21.7%
	TOTALI I MINISTRISË	27.4%

Analizë e përgjithshme

Nga një vështrim i përgjithshëm mbi realizimin e shpenzimeve të planifikuara për periudhën janar–prill 2026, niveli i përgjithshëm i realizimit për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit paraqitet në masën 27.4% të planit vjetor të rishikuar, duke reflektuar një ecuri përgjithësisht të qëndrueshme të shpenzimeve korente, ndërkohë që shpenzimet kapitale kërkojnë ndjekje të shtuar gjatë periudhave në vijim..

Ky nivel realizimi lidhet kryesisht me peshën dominuese të transfertave korente të brendshme, veçanërisht në kuadër të Programit “Sigurimet Shoqërore”, i cili përbën pjesën më të madhe të strukturës së shpenzimeve buxhetore të ministrisë. Gjatë periudhës raportuese, ky program ka realizuar shpenzime në vlerën 8,755,300 mijë lekë, ose 31.0% të planit vjetor të rishikuar, duke ndikuar ndjeshëm në nivelin total të realizimit të ministrisë.

Në të njëjtën kohë, shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në nivele të qëndrueshme, respektivisht në masën 31.2% për artikullin 600 “Paga” dhe 31.2% për artikullin 601 “Sigurime shoqërore”, duke garantuar funksionimin normal të strukturave të ministrisë dhe institucioneve të varësisë gjatë periudhës janar–prill 2026.

Realizimi i shpenzimeve kapitale paraqitet në nivel të ulët, përkatësisht 1.0% të planit vjetor të rishikuar. Ky nivel lidhet kryesisht me fazën fillestare të vitit buxhetor, proceset e detajimit, përgatitjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit, lidhjen e kontratave, si dhe ecurinë fizike të projekteve, të cilat zakonisht reflektohen financiarisht në periudhat pasuese të vitit.

Ky nivel realizimi kërkon ndjekje të shtuar gjatë periudhave në vijim, pasi një pjesë e projekteve kapitale janë ende në faza paraprake ose procedurale. Në disa raste, ecuria e projekteve nuk reflektohet ende në pagesa faktike, por në hapa përgatitorë, si hartimi i specifikimeve teknike, përcaktimi i fondit limit, dërgimi i praktikave pranë AKSHI-së ose Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, pritja e lejeve apo miratimeve nga institucionet përgjegjëse, plotësimi i dokumentacionit teknik dhe pronësor, si dhe procesi i çngurtësimit të fondeve. Për këtë arsye, është e nevojshme që institucionet zbatuese të vijnë

raportimin periodik mbi statusin e çdo projekti, afatet e pritshme të realizimit dhe problematikat që ndikojnë në ecurinë financiare, me qëllim uljen e riskut të mosrealizimit deri në fund të vitit buxhetor.

Duke iu referuar Aneksit nr. 1 të monitorimit për shpërndarjen e buxhetit ndër 9 programet e ministrisë, më poshtë paraqitet struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas vitit paraardhës, planit fillestar, planit të rishikuar dhe faktit të realizuar gjatë periudhës raportuese:

Tabelë 1 Struktura e shpenzimeve

Emërtimi i programit	Struktura e shpenzimeve në % viti paraardhës 2025	Struktura e shpenzimeve në % sipas planit fillestar 2026	Struktura e shpenzimeve në % sipas planit të rishikuar 2026	Struktura e shpenzimeve në % sipas faktit 4-mujor 2026
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0%	1%	1%	1%
Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	2%	1%	1%	0%
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	1%	1%	1%	1%
Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale	1%	1%	1%	1%
Inspektimi në Punë	0%	1%	1%	1%
Strehimi	2%	3%	3%	1%
Arsimi i Mesëm Profesional	6%	12%	12%	9%
Sigurimet Shoqërore	82%	68%	68%	77%
Tregu i Punës	4%	12%	12%	9%
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë	100%	100%	100%	100%

Nga analiza e strukturës së shpenzimeve sipas programeve buxhetore, rezulton se buxheti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit ka përqendrim më të lartë në programin “Sigurimet Shoqërore”, i cili përbën 82% të shpenzimeve në vitin paraardhës 2025, 68% sipas planit fillestar dhe planit të rishikuar 2026, si dhe 77% sipas faktit 4-mujor 2026. Kjo tregon se, edhe pse pesha relative e këtij programi në planifikimin e vitit 2026 është më e ulët krahasuar me vitin 2025, ai vijon të mbetet programi me ndikimin më të madh në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve të ministrisë.

Në vijim, programet “Arsimi i Mesëm Profesional” dhe “Tregu i Punës” paraqesin rritje të peshës së tyre në strukturën e buxhetit për vitin 2026. Programi “Arsimi i Mesëm Profesional” rritet nga 6% në vitin 2025 në 12% sipas planit fillestar dhe planit të rishikuar 2026, ndërsa sipas faktit 4-mujor rezulton në nivelin 9%. Po kështu, programi “Tregu i Punës” rritet nga 4% në vitin 2025 në 12% sipas planit fillestar dhe planit të rishikuar 2026, ndërsa në faktin 4-mujor 2026 rezulton në nivelin 9%. Kjo ecuri reflekton orientimin e buxhetit drejt politikave të arsimit profesional, formimit profesional, punësimit dhe mbështetjes së tregut të punës, si fusha me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik dhe social.

Programi “Strehimi” zë një peshë prej 2% në vitin paraardhës 2025 dhe 3% sipas planit fillestar dhe planit të rishikuar 2026, ndërsa sipas faktit 4-mujor 2026 rezulton në nivelin 1%. Kjo diferencë ndërmjet planifikimit vjetor dhe faktit 4-mujor lidhet me natyrën specifike të këtij programi, ku realizimi i shpenzimeve varet nga ecuria e procedurave, transferimi i fondeve dhe zbatimi i projekteve apo skemave përkatëse gjatë vitit buxhetor.

Programet “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji”, “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik”, “Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut,

Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale” dhe “Inspektimi në Punë” kanë peshë më të kufizuar në strukturën totale të shpenzimeve, duke u luhatur kryesisht në nivelet 0%–2%. Kjo lidhet me karakterin administrativ, mbështetës, rregullator, inspektues dhe zhvillimor të këtyre programeve, të cilat, megjithëse nuk zënë peshën kryesore në totalin e buxhetit, mbeten të rëndësishme për funksionimin institucional, mbështetjen e sipërmarrjes, inovacionit, mbikëqyrjes së tregut dhe garantimin e standardeve në fushat përkatëse.

Në tërësi, struktura e shpenzimeve evidenton se buxheti i ministrisë për vitin 2026 është i orientuar kryesisht drejt financimit të programeve me ndikim të drejtpërdrejtë social dhe ekonomik, ku pjesën dominuese e zënë sigurimet shoqërore, arsimi profesional, inovacioni dhe tregu i punës. Fakti 4-mujor i vitit 2026 tregon se realizimi i shpenzimeve ruan përqendrimin kryesor te programi “Sigurimet Shoqërore”, ndërkohë që programet e tjera reflektojnë një ecuri më graduale, në varësi të natyrës së shpenzimeve, kalendarit të zbatimit dhe procedurave përkatëse buxhetore.

INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Për periudhën janar–prill 2026, plani vjetor i rishikuar i shpenzimeve buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit është në vlerën 41,716,909 mijë lekë, ndërsa shpenzimet faktike progresive janë realizuar në masën 11,437,411 mijë lekë, duke reflektuar një nivel realizimi prej 27.4% të planit vjetor të rishikuar.

Tabelë 2 Realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve buxhetore, 4-mujori 2026 në mijë lekë

Përshkrimi	Plani fillestar 2026	Plani i rishikuar 2026	Shpenzime faktike 4-mujori 2026	Realizimi %
Shpenzime korente	39,302,949	39,311,949	11,413,406	29.0%
Shpenzime kapitale	2,404,960	2,404,960	24,005	1.0%
Totali buxhetor	41,707,909	41,716,909	11,437,411	27.4%

Nga analiza e realizimit të buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve, rezulton se për vitin 2026 Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka një plan fillestar në vlerën 41,707,909 mijë lekë, i cili pas rishikimeve buxhetore është rritur lehtësisht në 41,716,909 mijë lekë. Për 4-mujorin e vitit 2026, shpenzimet faktike arrijnë në 11,437,411 mijë lekë, ose 27.4% të planit të rishikuar vjetor. Realizimi është mbështetur kryesisht nga shpenzimet korente, të cilat janë realizuar në masën 29.0%, ndërsa shpenzimet kapitale paraqiten në nivel të ulët realizimi, me 24,005 mijë lekë ose 1.0% të planit të rishikuar. Ky nivel tregon se ecuria e përgjithshme e buxhetit është ndikuar kryesisht nga realizimi i shpenzimeve korente, ndërkohë që investimet kërkojnë ndjekje më të afërt gjatë muajve në vijim, me qëllim përshpejtimin e procedurave dhe rritjen e nivelit të realizimit financiar.

Sipas zërave të shpenzimeve buxhetore, duke përjashtuar edhe të ardhurat jashtë limitit, niveli i realizimit është 29 % dhe situata për çdo program për vitin 2026 paraqitet e tillë:

Tabelë 3 Realizimi i shpenzimeve në %

Emërtimi i Programit	Realizimi i shpenzimeve korente 4-mujori 2026 (%)	Shpenzime kapitale të brendshme 4-mujori 2026 (%)	Totali i shpenzimeve buxhetore 4-mujori 2026 (%)
----------------------	---	---	--

Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	32.0%	0.1%	29.8%
Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	10.0%	0.0%	9.7%
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	22.0%	26.5%	22.4%
Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale	32.6%	0.0%	31.2%
Inspektimi në Punë	26.6%	43.8%	27.4%
Strehimi	10.3%	0.0%	6.2%
Arsimi i Mesëm Profesional	28.3%	0.7%	20.0%
Sigurimet Shoqërore	31.0%	-	31.0%
Tregu i Punës	26.1%	0.0%	21.7%
TOTALI I MINISTRISË	29.0%	1.3%	27.4%

Nga analiza e realizimit të shpenzimeve buxhetore sipas programeve për 4-mujorin e vitit 2026, rezulton se niveli i përgjithshëm i realizimit për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit është 27.4%. Realizimi është mbështetur kryesisht nga shpenzimet korente, të cilat janë realizuar në masën 29.0%, ndërsa shpenzimet kapitale të brendshme paraqiten në nivel të ulët realizimi, me 1.3%. Për shpenzimet kapitale me financim të huaj, në mungesë të realizimit të evidentuar në këtë tabelë, ato paraqiten të ndara si kategori më vete, me qëllim pasqyrimin e plotë të strukturës së financimit dhe ndjekjen e ecurisë së tyre gjatë periudhës në vijim.

Programet me nivel më të lartë realizimi të shpenzimeve buxhetore janë “Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale” me 31.2%, “Sigurimet Shoqërore” me 31.0% dhe “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” me 29.8%. Ndërkohë, programet “Strehimi” dhe “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji” paraqesin nivele më të ulëta realizimi, përkatësisht 6.2% dhe 9.7%, kryesisht për shkak të ecurisë më të ngadaltë të zbatimit të fondeve dhe realizimit të kufizuar të shpenzimeve kapitale.

Në tërësi, realizimi 4-mujor tregon se zbatimi i buxhetit është orientuar kryesisht drejt shpenzimeve korente, ndërsa shpenzimet kapitale, si me financim të brendshëm ashtu edhe me financim të huaj, kërkojnë ndjekje më të afërt, me qëllim përshpejtimin e procedurave dhe rritjen e nivelit të realizimit financiar gjatë muajve në vijim.

Nga monitorimi i zbatimit të buxhetit për periudhën janar–prill 2026 rezulton se realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit është në masën 27.4% të planit vjetor të rishikuar. Ky nivel realizimi është mbështetur kryesisht nga shpenzimet korente, të cilat paraqiten në nivel më të qëndrueshëm, veçanërisht në artikujt 600 “Paga”, 601 “Sigurime shoqërore” dhe 604 “Transferta korente të brendshme”. Ndërkohë, shpenzimet kapitale paraqiten në nivel të ulët realizimi, duke përbërë fushën kryesore që po ndiqet gjatë periudhave në vijim.

Programi me ecurinë më të mirë financiare është 04130 – Mbështetje për Zhvillim Ekonomik, me realizim 27.1%. Megjithatë, realizimi financiar në këtë program është i përqendruar kryesisht në aparatin e ministrisë për TVSH-në e projekteve me financim të huaj dhe në projektin e ATRAKO-s për blerje pajisje kompjuterike. Ndërkohë, AIDA dhe QKB kanë ende projekte me realizim të ulët ose 0%, për të cilat kërkohet ndjekje më e strukturuar.

Në programin 04160 – Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale, mungesa e realizimit financiar lidhet kryesisht me faktin se projektet janë ende në faza përgatitore. DPM ka avancuar me specifikimet teknike dhe ndodhet në fazën e sigurimit të ofertave për përcaktimin e fondit limit.

Në programin 06190 – Strehimi, megjithëse nuk reflektohet realizim financiar, duhet evidentuar se një pjesë e fondeve janë rialokuar së fundmi tek bashkitë, me qëllim mbylljen e projekteve të nisura gjatë vitit 2025. Për këtë arsye, niveli aktual 0% lidhet më tepër me momentin e pasqyrimit të likuidimeve dhe ecurinë e raportimit nga njësitë vendore, sesa me mungesë totale të aktivitetit në program.

Programi 09240 – Arsimi i Mesëm Profesional ka realizim 1.0%, ndërsa programet e tjera rezultojnë me realizim shumë të ulët ose zero. Në shumë raste, ecuria nuk reflektohet ende në pagesa, por në hapa paraprakë si hartimi i specifikimeve teknike, përllogaritja e fondit limit, dërgimi i praktikave pranë AKSHI-së ose OBP-së, miratimi i dokumenteve nga Thesari, pritja e lejeve nga AZHT, si dhe plotësimi i dokumentacionit të pronësisë. Për këtë arsye, realizimi financiar pritet të ketë rritje në muajt pasardhës, por vetëm nëse institucionet zbatuese ndjekin me afate të qarta proceset e nisura.

Risku më i lartë lidhet me programet me peshë të madhe buxhetore dhe realizim të ulët, veçanërisht 09240 – Arsimi i Mesëm Profesional, 06190 – Strehimi dhe 10550 – Tregu i Punës. Gjithashtu, vërehen problematika të përsëritura që lidhen me pritjen e lejeve nga AZHT, mungesën ose pasaktësinë e dokumentacionit të pronësisë, varësinë nga procedurat e AKSHI-së dhe OBP-së, si dhe nevojën për çngurtësim fondesh në disa projekte. Këto elemente duhet të trajtohen si faktorë risku në monitorimin periodik të investimeve.

Struktura e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik

Shpenzimet korente përbëjnë peshën kryesore të buxhetit të ministrisë për vitin 2026, me një realizim faktik për periudhën janar–prill në vlerën **11,413,406 mijë lekë**, ndaj një plani vjetor të rishikuar prej **39,311,949 mijë lekë**, duke reflektuar një nivel realizimi prej **29.0%**.

Në strukturën e shpenzimeve korente dominojnë transfertat korente të brendshme, të cilat lidhen kryesisht me pagesat për sigurimet shoqërore dhe programe të tjera mbështetëse. Artikulli 604 “Transferta korente të brendshme” është realizuar në vlerën **8,755,300 mijë lekë**, ose **30.5%** të planit vjetor të rishikuar.

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në nivele të qëndrueshme. Artikulli 600 “Paga” është realizuar në vlerën **1,364,844 mijë lekë**, ose **31.2%**, ndërsa artikulli 601 “Sigurime shoqërore” është realizuar në vlerën **222,612 mijë lekë**, ose **31.2%** të planit vjetor të rishikuar.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar në vlerën **206,239 mijë lekë**, ose **20.8%** të planit vjetor të rishikuar, duke reflektuar ritmin më të moderuar të realizimit të shpenzimeve operative në katërmujorin e parë.

Shpenzimet kapitale për periudhën janar–prill 2026 janë realizuar në vlerën **24,005 mijë lekë**, ndaj një plani vjetor të rishikuar prej **2,404,960 mijë lekë**, me nivel realizimi **1.0%**. Ky nivel lidhet kryesisht me fazën fillestare të vitit buxhetor dhe me faktin se projektet e investimeve janë në proces detajimi, përgatitjeje dokumentacioni, prokurimi apo lidhjeje kontratash.

Tabelë 4 Plani fillestar, plani i rishikuar, realizimi faktik dhe struktura e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, 4-mujori 2026

Nr	Emri i Programit	Plani fillestar 2026	Plani i rishikuar 2026	Struktura % plani i rish.	Fakti 4-mujori 2026	Realizimi %	Struktura faktike %
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	569,048	569,848	1%	169,821	29.8%	1%

2	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	578,623	578,723	1%	56,113	9.7%	0%
3	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	518,325	518,975	1%	116,446	22.4%	1%
4	Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale	430,922	432,212	1%	134,857	31.2%	1%
5	Inspektimi në Punë	297,984	298,844	1%	81,945	27.4%	1%
6	Strehimi	1,245,000	1,245,000	3%	76,826	6.2%	1%
7	Arsimi i Mesëm Profesional	4,919,790	4,923,590	12%	985,696	20.0%	9%
8	Sigurimet Shoqërore	28,273,670	28,273,670	68%	8,755,300	31.0%	77%
9	Tregu i Punës	4,874,547	4,876,047	12%	1,060,407	21.7%	9%
	TOTALI I MINISTRISË	41,707,909	41,716,909	100%	11,437,411	27.4%	100%

Ndryshimet e planit buxhetor gjatë vitit

Nga krahasimi i planit fillestar me planin vjetor të rishikuar për periudhën janar–prill 2026, rezulton se buxheti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit ka pësuar një rritje neto prej 9,000 mijë lekë, nga 41,707,909 mijë lekë në planin fillestar, në 41,716,909 mijë lekë në planin e rishikuar.

Ky ndryshim nuk përbën rritje të ndjeshme të buxhetit total të ministrisë, por lidhet kryesisht me çeljen e fondit të veçantë, si dhe me disa rialokime të brendshme ndërmjet artikujve buxhetorë, të kryera me qëllim përshtatjen e planit me nevojat reale të programeve dhe institucioneve gjatë periudhës raportuese.

Në nivel programesh buxhetore, ndryshimet e planit janë të kufizuara dhe paraqiten si më poshtë:

Tabelë 5 Ndryshimet e planit buxhetor sipas programeve, viti 2026 në mijë lekë

Kodi i Programit	Emërtimi	Plani fillestar 2026	Plani vjetor i rishikuar 2026	Ndryshimi i planit vjetor
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	569,048	569,848	800
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	578,623	578,723	100
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	518,325	518,975	650
04160	Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale	430,922	432,212	1,290
04170	Inspektimi në Punë	297,984	298,844	860
06190	Strehimi	1,245,000	1,245,000	0
09240	Arsimi i Mesëm Profesional	4,919,790	4,923,590	3,800
10220	Sigurimet Shoqërore	28,273,670	28,273,670	0
10550	Tregu i Punës	4,874,547	4,876,047	1,500
	TOTALI	41,707,909	41,716,909	9,000

Për vitin 2026 buxheti i miratuar u detajua sipas Ligjit nr. 87/2025. Siç e dhe u citua me sipër gjatë vitit buxheti pësoi ndryshime, të cilat konsistojnë në ndryshime vetëm për shtesa të fondit të veçantë.

Tabela më sipër paraqet planin e rishikuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Ligji i buxhetit nr. 87/2025, është miratuar detajimi si më poshtë:

- Nr. 139/2 prot., datë 16.01.2026 “Dërgohet detajimi i shpenzimeve korente për vitet 2026–2028”
- Nr. 1138/1 prot., datë 20.02.2026 “Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2026”
- Nr. 139/7 prot., datë 13.03.2026 “Detajimi pjesor i buxhetit 2026–2028 për shpenzimet kapitale”

-
- Nr. 139/9 prot., datë 20.04.2026 “Detajimi pjesor i buxhetit 2026–2028 për shpenzimet kapitale”

Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve të secilit program:

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi

Në kuadër të zbatimit të buxhetit të vitit 2026, Programi 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” paraqitet me një buxhet të rishikuar në shumën totale prej 569,848 mijë lekë, nga të cilat 529,848 mijë lekë i përkasin shpenzimeve korente dhe 40,000 mijë lekë shpenzimeve kapitale.

Në total për vitin 2026 kemi rritje të buxhetit në shumën 800 mijë lekë, krahasuar me planin fillestar të evidentuar në tabelë, e cila reflektohet në artikullin buxhetor të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601, fondi është në shumën 414,000 mijë lekë, pa ndryshime të evidentuara.

Në artikullin 602, fondi është në shumën 82,000 mijë lekë, pa ndryshime të evidentuara.

Në artikullin 605, fondi është në shumën 30,000 mijë lekë, pa ndryshime të evidentuara.

Në artikullin 606, kemi shtesë fondi në shumën 800 mijë lekë, duke e çuar fondin nga 3,048 mijë lekë në 3,848 mijë lekë.

Në artikullin 231, fondi është në shumën 40,000 mijë lekë, pa ndryshime të evidentuara në këtë fazë. Këtu kemi parashikuar të bihen pajisje IT, zyre dhe automjete.

2. Programi Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji - 01150

Për vitin 2026, Programi 01150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji” paraqitet me fond fillestar në shumën 561,623 mijë lekë. Gjatë zbatimit të buxhetit, në këtë program janë reflektuar shtesa për FV nëpërmjet shkresës nr. 1138/2 prot., datë 26.02.2026, si dhe shkresës për rishikim të shpenzimeve celulare nga 602 në 606, nr. 1222/3 prot., datë 10.03.2026.

Në total, programi ka pësuar shtesë neto fondi në shumën 100 mijë lekë, ndërkohë që një pjesë e lëvizjeve ka karakter rialokimi të brendshëm ndërmjet artikujve buxhetorë, pa efekt në totalin e programit.

Në artikullin 600 dhe 601, fondi i planifikuar është në shumën 243,373 mijë lekë, nga të cilat 221,933 mijë lekë në artikullin 600 “Paga” dhe 21,440 mijë lekë në artikullin 601 “Kontribute për sigurime shoqërore”. Për këto artikuj nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në artikullin 602, fondi i planifikuar është në shumën 18,250 mijë lekë. Në këtë artikull evidentohet një shtesë prej 50 mijë lekë për Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen e Startup-eve, si dhe një pakësim prej 48 mijë lekë pranë Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës, si rezultat i rialokimit të brendshëm drejt artikullit 606. Si efekt neto, artikulli 602 rritet me 2 mijë lekë.

Në artikullin 604, fondi i planifikuar është në shumën 300,000 mijë lekë, i lidhur me produktin “Kompani Start Up të Mbështetura” pranë Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen e Startup-eve. Për këtë artikull nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në artikullin 606, fillimisht nuk ka pasur fond të planifikuar në tabelë, ndërsa gjatë vitit janë reflektuar shtesa në shumën totale 98 mijë lekë. Nga këto, 50 mijë lekë lidhen me shtesën sipas shkresës nr. 1138/2 prot., datë 26.02.2026, ndërsa 48 mijë lekë përfaqësojnë rialokim të brendshëm nga artikulli 602, sipas shkresës nr. 1222/3 prot., datë 10.03.2026.

Në artikullin 231, për shpenzime kapitale, Programi 01150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji” paraqitet me fond në shumën 17,000 mijë lekë me financim të brendshëm. Ky fond është i shpërndarë si vijon: 10,000 mijë lekë për Aparatin e Ministrisë së Ekonomisë dhe

Inovacionit për projektin “Fond i ngrirë”, i cili është në proces për cngurtësim, sepse është parashikua për sitëm arkive, 3,000 mijë lekë për Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për “Pajisje zyre AIE”, si dhe 4,000 mijë lekë për Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për “Pajisje kompjuterike AIE”.

Gjithashtu, në këtë program evidentohet edhe projekti me financim të huaj “Net4Green”, pranë Agjencisë “Innovation4Albania”, për të cilin gjatë muajit maj është reflektuar shtesa prej 6,800 mijë lekë në financimin e huaj. Kjo shtesë lidhet me çeljen/përditësimin e fondeve të projektit me financim të huaj dhe trajtohet veçmas nga rialokimet e brendshme të programit.

Në përfundim, ndryshimet në Programin 01150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji” kanë karakter kryesisht teknik dhe zbatues, si dhe start up-e. Në shpenzimet korente, programi ka pësuar shtesë neto prej 100 mijë lekë, e cila lidhet me nevoja të kufizuara në artikujt 602 dhe 606, ndërsa rialokimi prej 48 mijë lekë nga artikulli 602 në artikullin 606 nuk ndryshon totalin e programit, por pasqyron rishpërndarjen e fondit sipas natyrës së shpenzimit. Në shpenzimet kapitale, programi paraqitet me 17,000 mijë lekë financim të brendshëm, si dhe me shtesë prej 6,800 mijë lekë financim të huaj për projektin “Net4Green”.

3. Programi Mbështetje për Zhvillim Ekonomik - 04130

Për vitin 2026, Programi 04130 “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” paraqitet me fond fillestar në shumën 467,155 mijë lekë për shpenzimet korente, si dhe 48,170 mijë lekë për shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe 3,000 mije FH. Në total, programi paraqitet me fond fillestar prej 515,325 mijë lekë.

Gjatë vitit, në këtë program janë reflektuar ndryshime nëpërmjet shkresës nr. 1138/2 prot., datë 26.02.2026, shkresës nr. 1222/3 prot., datë 10.03.2026, si dhe shkresës nr. 3212/1 prot., datë 21.04.2026. Ndryshimet kanë kryesisht karakter teknik për zhvillim panairësh dhe aktivitet për zhvillimin e investimeve të huaja, me efekt neto shtesë në shumën 650 mijë lekë, të lidhur kryesisht me fondin e veçantë.

Në artikullin 600 dhe 601, fondi i planifikuar është në shumën 240,408 mijë lekë, nga të cilat 211,667 mijë lekë në artikullin 600 “Paga” dhe 28,741 mijë lekë në artikullin 601 “Kontribute për sigurime shoqërore”. Për këto artikuj nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në artikullin 602, fondi i planifikuar është në shumën 122,206 mijë lekë. Në këtë artikull janë reflektuar rialokime të brendshme pa efekt neto në totalin e programit, konkretisht shtesë prej 12,000 mijë lekë pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe pakësim në të njëjtën vlerë pranë Aparatit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Gjithashtu, evidentohet një lëvizje e brendshme prej 24 mijë lekë nga artikulli 602 drejt artikullit 606 pranë STKEK, pa efekt në totalin e programit për rimbursimet e shpenzimeve telefonike.

Në artikullin 604, fondi i planifikuar është në shumën 100,000 mijë lekë, i lidhur me mbështetjen në formë granti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Për këtë artikull nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në artikullin 605, fondi i planifikuar është në shumën 375 mijë lekë, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për shërbimet e ofruara për bizneset sipas sistemit të Regjistrimit të Biznesit. Për këtë artikull nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në artikullin 606, fondi fillestar është në shumën 644 mijë lekë. Gjatë vitit janë reflektuar shtesa në shumën totale 674 mijë lekë, nga të cilat 650 mijë lekë përfaqësojnë shtesë neto fondi, ndërsa 24 mijë lekë përfaqësojnë rialokim të brendshëm nga artikulli 602. Shtesat lidhen kryesisht me fondin e veçantë për institucionet e programit, konkretisht për Qendrën Kombëtare të Biznesit, Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve dhe STKEK.

Në **artikullin 231**, për shpenzime kapitale, Programi 04130 “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” paraqitet me fond në shumën 48,170 mijë lekë me financim të brendshëm. Ky fond përfshin 28,100 mijë lekë për Aparatin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për TVSH për projektet me financim të huaj, 3,800 mijë lekë për Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve për blerje pajisjesh kompjuterike, 8,450 mijë lekë për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, si dhe 7,820 mijë lekë për Qendrën Kombëtare të Biznesit për projekte investimi, përfshirë projektin Preventiv, rikonstrukcion zyresh, blerje pajisjesh zyre, pajisje kompjuterike dhe pajisje audiovizuale. Kemi dhe FH 3,000 mije leje per projektin Projekti EEN Albania.

Në përfundim, ndryshimet në Programin 04130 “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” lidhen kryesisht me shtesën neto prej 650 mijë lekë në artikullin 606 për fondin e veçantë, si dhe me rialokime të brendshme ndërmjet artikujve dhe institucioneve, pa efekt në totalin e programit. Rialokimi prej 12,000 mijë lekë nga Aparati i Ministrisë drejt Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve në artikullin 602 ka karakter rishpërndarës dhe synon orientimin e fondeve drejt institucionit ku paraqitet nevoja për realizimin e shpenzimit.

4. Programi Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale - 04160

Për vitin 2026, Programi 04160 “Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale” paraqitet me fond fillestar për shpenzimet korente në shumën 412,922 mijë lekë, si dhe me fond për shpenzime kapitale me financim të brendshëm në shumën 18,000 mijë lekë. Në total, programi paraqitet me fond fillestar prej **430,922 mijë lekë**.

Gjatë vitit, në këtë program janë reflektuar ndryshime nëpërmjet shkresës nr. 1138/2 prot., datë 26.02.2026, si dhe shkresës nr. 3037/1 prot., datë 08.05.2026. Ndryshimet lidhen kryesisht me shtesë fondi në artikullin 606 për fondin e veçantë, si dhe me një rialokim të brendshëm në artikullin 605 ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, pa efekt në totalin e programit.

Në **artikullin 600 dhe 601**, fondi i planifikuar është në shumën 330,222 mijë lekë, nga të cilat **282,900 mijë lekë** në artikullin 600 “Paga” dhe 47,322 mijë lekë në artikullin 601 “Kontribute për sigurime shoqërore”. Për këto artikuj nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në **artikullin 602**, fondi i planifikuar është në shumën 61,508 mijë lekë, i shpërndarë ndërmjet institucioneve të programit për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të funksionimit. Për këtë artikull nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në **artikullin 605**, fondi i planifikuar është në shumën 21,000 mijë lekë, i lidhur me transfertat korente të huaja/anëtarësimet ndërkombëtare të institucioneve të programit. Në këtë artikull evidentohet një rialokim i brendshëm në shumën 3,700 mijë lekë, ku fondi pakësohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe shtohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Ky rialokim ka karakter teknik dhe lidhet me përmbushjen e detyrimeve për anëtarësimet ndërkombëtare, pa ndryshuar totalin e programit.

Në **artikullin 606**, fondi fillestar është në shumën 192 mijë lekë. Gjatë vitit është reflektuar shtesë fondi në shumën 1,290 mijë lekë, e shpërndarë ndërmjet institucioneve të programit, konkretisht për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit dhe Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut. Kjo shtesë lidhet me fondin e veçantë dhe mbulimin e nevojave specifike institucionale për anëtarësimin në organizatën e metrikes.

Në **artikullin 231**, për shpenzime kapitale, Programi 04160 paraqitet me fond në shumën 18,000 mijë lekë me financim të brendshëm. Ky fond përfshin 16,000 mijë lekë për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për projektin “Blerje pajisje për kompletimin e laboratorëve të

DPM”, si dhe 2,000 mijë lekë për Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut për projektin “Blerje automjete”.

Në përfundim, ndryshimet në Programin 04160 lidhen kryesisht me shtesën neto prej 1,290 mijë lekë në artikullin 606 për fondin e veçantë, si dhe me rialokimin e brendshëm prej 3,700 mijë lekë në artikullin 605 ndërmjet institucioneve të programit, pa efekt në totalin e tij. Shpenzimet kapitale mbeten në shumën 18,000 mijë lekë, të orientuara kryesisht për pajisje laboratorike të metrologjisë dhe blerje automjesh për mbikëqyrjen e tregut.

5. Programi Inspektimi në Punë - 04170

Për vitin 2026, Programi 04170 “Inspektimi në Punë” paraqitet me fond fillestar për shpenzimet korente në shumën 282,984 mijë lekë, si dhe me fond për shpenzime kapitale me financim të brendshëm në shumën 15,000 mijë lekë. Në total, programi paraqitet me fond fillestar prej 297,984 mijë lekë. Gjatë vitit, në këtë program është reflektuar ndryshim nëpërmjet shkresës nr. 1138/2 prot., datë 26.02.2026, në artikullin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë” për FV.

Në artikullin 600 dhe 601, fondi i planifikuar është në shumën 248,979 mijë lekë, nga të cilat 206,979 mijë lekë në artikullin 600 “Paga” dhe 42,000 mijë lekë në artikullin 601 “Kontribute për sigurime shoqërore”. Për këto artikuj nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në artikullin 602, fondi i planifikuar është në shumën 33,957 mijë lekë, për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të funksionimit të Administratës Qendrore të ISHP/ISHPSHSH. Për këtë artikull nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në artikullin 606, fondi fillestar është në shumën 48 mijë lekë. Gjatë vitit është reflektuar shtesë fondi në shumën 860 mijë lekë, duke e çuar këtë artikull në shumën 908 mijë lekë. Kjo shtesë lidhet me fondin e veçantë dhe mbulimin e nevojave specifike të institucionit me natyrë transferte.

Në artikullin 231, për shpenzime kapitale, Programi 04170 “Inspektimi në Punë” paraqitet me fond në shumën 15,000 mijë lekë me financim të brendshëm. Ky fond përfshin 10,000 mijë lekë për projektin “Blerje Automjeti”, 4,200 mijë lekë për projektin “Blerje pajisje elektronike/kompjuterë”, si dhe 800 mijë lekë për projektin “Blerje pajisje të ndryshme për zyra dhe mbrojtja ndaj zjarrit”.

Në përfundim, ndryshimi në Programin 04170 “Inspektimi në Punë” lidhet me shtesën neto prej 860 mijë lekë në artikullin 606, për fondin e veçantë. Shpenzimet kapitale mbeten në shumën 15,000 mijë lekë, të orientuara për mbështetjen me mjete transporti, pajisje elektronike/kompjuterike dhe pajisje të tjera për nevojat funksionale të institucionit.

6. Programi Strehimi - 06190

Për vitin 2026, Programi 06190 “Strehimi” paraqitet me fond fillestar për shpenzimet korente në shumën 745,000 mijë lekë, të planifikuar në artikullin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, si dhe me fond për shpenzime kapitale me financim të brendshëm në shumën 500,000 mijë lekë. Në total, programi paraqitet me fond fillestar prej 1,245,000 mijë lekë.

Gjatë vitit, në këtë program janë reflektuar rialokime nëpërmjet shkresës nr. 3489/1 prot., të cilat lidhen kryesisht me zbatimin e procedurave për transferimin e fondeve nga aparati i ministrisë drejt bashkive përfutuese, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor që rregullon programin e strehimit.

Në artikullin 606, fondi fillestar është në shumën 745,000 mijë lekë dhe përfshin financimin për skemat kryesore të programit, si kredi ekzistuese që subvencionohen, kredi të reja, bonus

qiraje, grant i menjëhershëm, si dhe subvencionim qiraje për banorë të shpronësuar nga Unaza Madhe Tiranë.

Në këtë artikull, rialokimet kanë karakter procedural dhe lidhen me kalimin e fondeve drejt bashkive përfituese. Konkretisht, fondet e çelura fillimisht në aparatin e ministrisë për bonusin e qirasë dhe grantin e menjëhershëm pakësohen në nivel aparati dhe rishpërndahen te bashkitë, sipas dokumentacionit të paraqitur dhe procedurave përkatëse të programit të strehimit.

Për bonusin e qirasë, evidentohet pakësimi nga Aparati i Ministrisë në shumën 162,780.9 mijë lekë, ndërkohë që fondet shpërndahen në bashki të ndryshme përfituese, ndër të cilat me vlera më të larta evidentohen Bashkia Kamëz, Bashkia Durrës, Bashkia Elbasan, Bashkia Klos, Bashkia Kurbin, Bashkia Shkodër, Bashkia Lezhë, Bashkia Prenjas, Bashkia Librazhd, Bashkia Belsh, Bashkia Dibër, Bashkia Berat dhe bashki të tjera.

Për grantin e menjëhershëm, në tabelë evidentohet pakësimi nga Aparati i Ministrisë në shumën 3,080.6 mijë lekë, ndërsa fondet transferohen në bashkitë përfituese, përfshirë Bashkinë Korçë, Bashkinë Berat, Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Lezhë.

Gjithashtu, në tabelë evidentohet edhe një shtesë në shumën 8,000 mijë lekë për Entin Kombëtar të Banesave, në artikullin 606, për bonus qiraje.

Në artikullin 231, për shpenzime kapitale, Programi 06190 “Strehimi” paraqitet me fond në shumën 500,000 mijë lekë me financim të brendshëm. Ky fond është i shpërndarë për projekte investimi që lidhen me përmirësimin e kushteve të banimit dhe strehimin social, konkretisht: 149,859.3 mijë lekë për projektet për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara, 200,140.8 mijë lekë për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian, 68,187.3 mijë lekë për adaptimin e godinave në pronësi të njësive të qeverisjes vendore për strehim social, si dhe 81,812.7 mijë lekë për projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi.

Në përfundim, ndryshimet në Programin 06190 “Strehimi” nuk përbëjnë pakësim të nevojave buxhetore, por reflektojnë mënyrën e zbatimit të programit, ku fondet çelen fillimisht në aparatin e ministrisë dhe më pas transferohen drejt bashkive përfituese sipas dokumentacionit dhe procedurave ligjore. Shpenzimet kapitale mbeten në shumën 500,000 mijë lekë, të orientuara për investime në strehim social, përmirësim kushtesh banimi dhe ndërhyrje infrastrukturore në funksion të komuniteteve përfituese.

7. Arsimi i Mesëm (profesional)

Për vitin 2026, Programi 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional” paraqitet me fond fillestar për shpenzimet korente në shumën 3,436,999.9 mijë lekë, si dhe me fond për shpenzime kapitale në shumën 1,482,790 mijë lekë, nga të cilat 1,002,790 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 480,000 mijë lekë me financim të huaj. Në total, programi paraqitet me fond fillestar prej 4,919,789.9 mijë lekë.

Gjatë vitit, në këtë program janë reflektuar disa rialokime, kryesisht për bursat e nxënësve të arsimit profesional, fondin e veçantë, si dhe disa lëvizje në shpenzimet operative të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional. Rialokimet për bursat kanë karakter procedural, pasi fondet çelen fillimisht në aparatin e ministrisë dhe më pas transferohen në bashkitë përfituese, pas paraqitjes dhe verifikimit të dokumentacionit përkatës. Njësoj për te njëjtat arsyeje edhe fondi i veçantë kështu trajtohet.

Në artikullin 600 dhe 601, fondi i planifikuar është në shumën 2,704,880 mijë lekë, nga të cilat 2,317,177 mijë lekë në artikullin 600 “Paga” dhe 387,703 mijë lekë në artikullin 601 “Kontribute për sigurime shoqërore”. Për këto artikuj nuk evidentohet ndryshim në tabelën e rialokimeve.

Në artikullin 602, fondi i planifikuar është në shumën 418,999.9 mijë lekë. Gjatë vitit janë reflektuar lëvizje të brendshme, me efekt neto shtesë rreth 216.1 mijë lekë. Në këtë artikull evidentohet pakësim prej 14,500 mijë lekë nga Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ndërkohë që janë shtuar fonde për disa institucione arsimore, si Shkolla Elektrike “Gjergj Canco” Tiranë, Shkolla e Shërbimeve Korçë, Shkolla Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë, për shpenzime transporti dhe operative, si dhe Bashkia Mirditë për kuota ushqimore për nxënës në konvikt. Gjithashtu, evidentohet një pakësim prej 24 mijë lekë nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, i cili kalon në artikullin 606 për ribursim telefoni.

Në artikullin 606, fondi fillestar është në shumën 313,120 mijë lekë. Në këtë artikull janë reflektuar kryesisht rialokimet për bursat dhe ribursim për librat e nxënësve të arsimit profesional, ku fondet pakësohen nga Aparati i Ministrisë dhe kalojnë në bashkitë përfituese. Konkretisht, nga Aparati i Ministrisë deri në 14 maj pakësohet fondi për bursa në shumën rreth 148,602.8 mijë lekë, ndërsa fondet shpërndahen në bashki, ndër të cilat me vlera më të larta evidentohen Bashkia Elbasan, Bashkia Kamëz, Bashkia Tiranë, Bashkia Pogradec, Bashkia Shkodër, Bashkia Berat, si dhe bashki të tjera përfituese sipas dokumentacionit të paraqitur.

Gjithashtu, në artikullin 606 janë reflektuar edhe shtesa të tjera me natyrë fondi të veçantë, në shumën neto rreth 3,583.9 mijë lekë, për institucione të arsimit dhe formimit profesional, përfshirë AKAFPK dhe disa shkolla profesionale. Këto lëvizje lidhen me mbulimin e nevojave specifike institucionale me natyrë transferte.

Në artikullin 231, për shpenzime kapitale, Programi 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional” paraqitet me fond në shumën totale 1,482,790 mijë lekë, nga të cilat 1,002,790 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 480,000 mijë lekë me financim të huaj.

Për financimin e brendshëm, fondet janë orientuar kryesisht për investime në infrastrukturën e arsimit profesional, përfshirë laboratorë, pajisje dhe makineri për repartet e praktikave profesionale, mobilje dhe pajisje për shkollat e arsimit profesional, blerje pajisjesh digjitale për sistemin e AFP-së, si dhe rikonstruksione në disa shkolla profesionale, ndër të cilat “Pavarësia” Vlorë, “Bajram Curri” Kukës, “Enver Qiraxhi” Pogradec, Shkolla Teknike Korçë, “Arben Broci”, “Hamdi Bushati” Shkodër, Karl Gega Tiranë, si dhe projekte të tjera të lidhura me përmirësimin e kushteve të mësimi dhe praktikës profesionale.

Për financimin e huaj, fondi prej 480,000 mijë lekë lidhet me projekte të ndryshme në mbështetje të arsimit dhe formimit profesional, ndër të cilat Skills for Job, Mbështetje të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit, Fondi Arsimor 2016 KfW, PROSEED Arsimit Profesional, EPALE, Adult Learning Agenda, DIGIVET, B4CVET, DigiGreenVET, CRAFTS-VET, si dhe projekte të tjera të zbatuara pranë institucioneve të arsimit profesional.

Në përfundim, ndryshimet në Programin 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional” kanë karakter kryesisht procedural dhe zbatues. Pjesa më e madhe e rialokimeve në artikullin 606 lidhet me transferimin e fondeve për bursat dhe librat e nxënësve drejt bashkive/shkollave përfituese, pas administrimit të dokumentacionit përkatës. Ndërkohë, ndryshimet në artikujt 602 dhe 606 reflektojnë edhe nevoja specifike të institucioneve për mbulim shpenzimesh operative dhe fond të veçantë. Shpenzimet kapitale mbeten me peshë të konsiderueshme në këtë program, duke mbështetur investimet në infrastrukturë, pajisje, digjitalizim dhe projekte me financim të huaj në arsimin profesional.

8. Tregu i punës

Për vitin 2026, Programi 10550 “Tregu i Punës” paraqitet me fond fillestar për shpenzimet korente në shumën rreth 4,493,989.9 mijë lekë, si dhe me fond për shpenzime kapitale në shumën 281,000 mijë lekë, nga të cilat 231,000 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 50,000 mijë lekë me financim të huaj. Në total, programi paraqitet me fond fillestar rreth 4,774,989.9 mijë lekë.

Gjatë vitit, në këtë program janë reflektuar disa detajime dhe lëvizje buxhetore, të cilat lidhen me funksionimin e strukturave përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, mbështetjen e politikave aktive të tregut të punës, pagesat dhe mbështetjet për përfituesit, si dhe realizimin e investimeve në infrastrukturë, pajisje dhe projekte me financim të huaj.

Në artikullin 600 “Paga” dhe artikullin 601 “Kontribute për sigurime shoqërore”, fondet lidhen me mbulimin e kostove të personelit të strukturave që zbatojnë politikat e punësimit dhe formimit profesional, përfshirë Drejtorinë Qendrore të AKPA-së, drejtoritë rajonale/vendore të punësimit dhe qendrat e formimit profesional. Këto fonde garantojnë vijimësinë e funksionimit institucional dhe ofrimin e shërbimeve ndaj punëkërkuessve, punëdhënësve dhe përfituesve të programeve aktive të tregut të punës.

Në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime”, fondet mbulojnë shpenzimet operative për administrimin e institucioneve dhe ofrimin normal të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional. Në këtë artikull përfshihen shpenzime për funksionimin e zyrave të punësimit dhe qendrave të formimit profesional, mirëmbajtje, shërbime mbështetëse, materiale pune, pajisje të vogla dhe nevoja të tjera të përditshme institucionale.

Në artikullin 603 “Subvencione”, fondet janë të orientuara kryesisht për zbatimin e programeve aktive të tregut të punës, me qëllim nxitjen e punësimit, mbështetjen e punëdhënësve, përfshirjen në tregun e punës të grupeve të veçanta, si dhe rritjen e mundësive për punësim të qëndrueshëm. Ky artikull ka peshë të rëndësishme në program, pasi lidhet drejtpërdrejt me masat mbështetëse për punëkërkuessit dhe përfituesit e skemave të miratuara.

Në artikullin 604 “Transferta korente të brendshme”, fondet lidhen me transferta dhe mbështetje në funksion të objektivave të programit, përfshirë mbështetjen e qendrave të formimit profesional publik, zbatimin e shërbimeve dhe programeve të lidhura me tregun e punës, si dhe mbulimin e detyrimeve me natyrë transferte sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Në artikullin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë”, fondet lidhen me pagesa dhe mbështetje direkte për individë, sipas programeve dhe skemave përkatëse të tregut të punës. Ky artikull reflekton mbështetjen për përfituesit individualë dhe masa të tjera që synojnë përfshirjen, aftësimin dhe riintegrimin në tregun e punës.

Në artikullin 231 “Shpenzime kapitale”, për financimin e brendshëm, fondi i planifikuar paraqitet në shumën 231,000 mijë lekë. Ky fond është detajuar kryesisht për projektin “Ndërtimi i Kampusit QFP” në shumën 115,000 mijë lekë, për “Studim-projektime për rikonstrukcione” në shumën 24,000 mijë lekë, për “Blerje kabinete për kurse formimi profesional” në shumën 25,000 mijë lekë, për “Pajisje zyre” në shumën 2,000 mijë lekë, si dhe për bashkëfinancim me projektet IPA në tregun e punës në shumën 65,000 mijë lekë.

Për financimin e brendshëm, fondet kapitale janë orientuar kryesisht drejt përmirësimit të infrastrukturës së qendrave të formimit profesional, krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e praktikave profesionale, pajisjes së kabineteve me bazë materiale dhe teknike, si dhe mbështetjes së projekteve që synojnë modernizimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional.

Në artikullin 231 “Shpenzime kapitale”, për financimin e huaj, fondi i planifikuar paraqitet në shumën 50,000 mijë lekë. Ky fond lidhet me projekte të ndryshme që zbatohen nëpërmjet AKPA-së dhe qendrave të formimit profesional, ndër të cilat projekti FCOD (AKPA) në shumën 22,876 mijë lekë, projekti VRIN VET (AKPA) në shumën 1,618 mijë lekë, projekti

VR Digi VET (AKPA) në shumën 3,255 mijë lekë, projekti CYBERFORT (AKPA) në shumën 1,832 mijë lekë, projekti WORLD VISION në shumën 5,599 mijë lekë, projekti ERASMUS EDU 2025 CB VET QFP Elbasan në shumën 4,467 mijë lekë, projekti CIRCULAR Turizëm – QFP Vlorë në shumën 2,470 mijë lekë, projekti ITC FOOD në shumën 5,886 mijë lekë, si dhe projekti pranë QFP nr. 1 Tiranë në shumën 1,996 mijë lekë.

Për financimin e huaj, fondet janë të lidhura kryesisht me projekte që mbështesin zhvillimin e aftësive profesionale, digjitalizimin e formimit profesional, përmirësimin e kapaciteteve të qendrave të formimit, zhvillimin e programeve të reja të trajnimit dhe përafrimin e ofertës së formimit me standardet dhe praktikatat evropiane.

Në përfundim, Programi 10550 “Tregu i Punës” ka një peshë të rëndësishme në buxhet, me një fond korent prej rreth 4,494 milionë lekë, i cili mbështet funksionimin e strukturave të punësimit dhe formimit profesional, zbatimin e politikave aktive të tregut të punës dhe mbështetjet për përfituesit. Ndërkohë, fondi kapital prej 281 milionë lekë mbështet investimet në infrastrukturë, pajisje dhe projekte me financim të brendshëm dhe të huaj. Në tërësi, programi kontribuon në rritjen e punësueshmërisë, zhvillimin e aftësive profesionale dhe përafrimin e ofertës së formimit me kërkesat reale të tregut të punës.

9. Sigurimi Shoqëror

Ky program karakterizohet nga shpenzime shumë të kufizuara korrente të alokuara në aparatin administrativ (artikujt 600 dhe 601), ndërsa pothuajse e gjithë pesha buxhetore është përqendruar në artikullin 604 – Transferta korente të brendshme, i cili përfaqëson financimin e skemave të sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve sociale. Për këtë periudhë nuk raportohen ndryshime të buxhetit.

Numri i rialokimeve të miratuara:

Deri në fund të periudhës, përveç shtesave që përmendëm dhe më sipër për çelje të fondit të veçantë, shtesë buxheti me VKM si dhe shtesë me Akt Normativ, kemi miratuar transferime që kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave që kanë paraqitur programet buxhetore si dhe disa avancime fondesh.

Me shume informacion gjeni ne anekset 2.

Numri i punonjësve

Në lidhje me numrin e punonjësve, për periudhën 04/2026 konstatohet se numri i punonjësve të planifikuar për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe institucionet e varësisë të detajuar në SIFQ është 3,129 punonjës, ndërsa numri faktik i punonjësve të paguar me bordero rezulton 2,979 punonjës, me një diferencë prej 150 punonjësish më pak se plani. Sipas tabelës të ligjit 87/2025 është 3,167, pra 38 janë të pashpërndarë. Në nivel programi, diferencat më të larta evidentohen në programin 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional”, programin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” dhe programin 01150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji”. Në nivel institucioni, diferencat më të ndjeshme paraqiten në Aparatin e Ministrisë, Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës, Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, si dhe në disa institucione të arsimit profesional dhe strukturave të AKPA-së. Këto diferenca tregojnë pranimin e vendeve të paplotësuara në strukturat përkatëse, të cilat duhet të ndiqen në vijimësi, si për efekt të realizimit të shpenzimeve për paga dhe kontribute, ashtu edhe për garantimin e kapaciteteve njerëzore të nevojshme për përmbushjen e funksioneve institucionale.

Tabela 6. Numri i punonjësve sipas programeve buxhetore, periudha 04/2026

Nr.	Kodi i programit	Emërtimi i programit buxhetor	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi ndaj planit
1	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	231	201	-30	87.0%
2	01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	85	58	-27	68.2%
3	04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	152	136	-16	89.5%
4	04160	Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale	219	198	-21	90.4%
5	04170	Inspektimi në Punë	163	159	-4	97.5%
6	09240	Arsimi i Mesëm Profesional	1,775	1,742	-33	98.1%
7	10550	Tregu i Punës	504	485	-19	96.2%
	TOTALI		3,129	2,979	-150	95.2%

Diferencat ndërmjet numrit të punonjësve të planifikuar dhe atij faktik lidhen kryesisht me vende të paplotësuara në strukturat organike të miratuara. Plotësimi i këtyre vakancave është në varësi të hapjes dhe vijimit të procedurave të rekrutimit nga Departamenti i Administratës Publike, sipas rregullave në fuqi për shërbimin civil dhe administratën publike. Për rrjedhojë, deri në përfundimin e këtyre procedurave, numri faktik i punonjësve të paguar me bordero do të vijojë të rezultojë më i ulët se numri i planifikuar, duke ndikuar edhe në realizimin e shpenzimeve për paga dhe kontribute.

Diferenca prej 150 punonjësish përfaqëson vende të paplotësuara në strukturat përkatëse, me një nivel mbulimi faktik prej 95.2% ndaj planit. Diferenca më e lartë në vlerë absolute paraqitet në programin 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional”, me 33 punonjës më pak, ndjekur nga programi 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, me 30 punonjës më pak, dhe programi 01150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji”, me 27 punonjës më pak. Në terma relativë, niveli më i ulët i plotësimit paraqitet në programin 01150, ku numri faktik përfaqëson vetëm 68.2% të planit.

Tabela 7. Institucionet me diferencën më të lartë ndërmjet planit dhe faktit

Nr.	Programi	Institucioni	Plan	Fakt	Diferenca	Realizimi ndaj planit
1	01110	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit	231	201	-30	87.0%
2	01150	Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës(*)	75	49	-26	65.3%
3	04160	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	98	83	-15	84.7%
4	09240	Shkolla “Beqir Çela”, Durrës	120	111	-9	92.5%
5	04130	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve	51	43	-8	84.3%
6	04130	Qendra Kombëtare e Biznesit	83	75	-8	90.4%
7	10550	Drejtoria Qendrore AKPA	82	76	-6	92.7%
8	04160	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	80	75	-5	93.8%
9	09240	Shkolla Profesionale “Karl Gega”, Tiranë	97	92	-5	94.8%
10	04170	Administrata Qendrore e ISHP-së	163	159	-4	97.5%
11	10550	Drejtoria Rajonale AKPA Lezhë	21	17	-4	81.0%
12	09240	Shkolla “Hysen Çela”, Durrës	86	82	-4	95.3%

13	09240	Shkolla Elektrike “Gjergj Canco”, Tiranë	108	104	-4	96.3%
----	-------	--	-----	-----	----	-------

(*) *Shënim:* Për Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës, diferenca ndërmjet numrit të punonjësve të planifikuar dhe atij faktik lidhet edhe me procesin e riorganizimit institucional. Gjatë vitit 2026, Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës është përfshirë në proces riorganizimi, si rezultat i bashkimit me strukturën/ish-Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen e Start-up dhe krijimit të strukturës së re “Innovation4Albania”. Për këtë arsye, plotësimi i pozicioneve vakante dhe reflektimi i plotë i strukturës në bordero pritet të realizohet pas përfundimit të procedurave administrative përkatëse dhe hapjes/vijimit të procedurave të rekrutimit. Kjo situatë shpjegon nivelin më të ulët të realizimit të numrit faktik të punonjësve në raport me planin, si dhe ndikon përkohësisht në ecurinë e realizimit të shpenzimeve për paga dhe kontribute

Për informacion përmblledhës, lutemi referojuni Aneksit nr. 1: Raporti Përmblledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor, po rre poshtë gjeni edhe te dhëna për cdo njësi shpenzuese të MEI.

Tabela 8. Numri i punonjësve të planifikuar dhe faktik sipas institucioneve, periudha 04/2026

Kod institucioni	Institucioni	Plan në SIFQ	Fakt	Diferenca	% realizimit
1004001	Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit	231	201	-30	87%
1004199	Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës	75	49	-26	65%
1004200	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve	51	43	-8	84%
1004201	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve	12	12	0	100%
1004202	Qendra Kombëtare e Biznesit	83	75	-8	90%
1004203	Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar	6	6	0	100%
1004204	Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e Start-up	10	9	-1	90%
1004205	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	98	83	-15	85%
1004206	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	80	75	-5	94%
1004207	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	15	15	0	100%
1004208	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	20	20	0	100%
1004209	Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve	6	5	-1	83%
1004210	Administrata Qendrore e ISHP-së	163	159	-4	98%
1004211	Drejtoria Rajonale AKPA Berat	20	19	-1	95%
1004212	Drejtoria Rajonale AKPA Dibër	20	20	0	100%
1004213	Drejtoria Rajonale AKPA Durrës	22	22	0	100%
1004214	Drejtoria Rajonale AKPA Elbasan	25	25	0	100%
1004215	Drejtoria Rajonale AKPA Fier	22	22	0	100%
1004216	Drejtoria Rajonale AKPA Gjirokastrë	20	20	0	100%
1004217	Drejtoria Rajonale AKPA Korçë	26	25	-1	96%
1004218	Drejtoria Rajonale AKPA Kukës	19	19	0	100%
1004219	Drejtoria Rajonale AKPA Lezhë	21	17	-4	81%
1004220	Drejtoria Rajonale AKPA Shkodër	23	23	0	100%
1004221	Drejtoria Rajonale AKPA Vlorë	22	20	-2	91%
1004222	Drejtoria Rajonale AKPA Tiranë	52	52	0	100%
1004223	Qendra e Formimit Profesional nr. 1 Tiranë	15	15	0	100%
1004224	Qendra e Formimit Profesional nr. 4 Tiranë	15	14	-1	93%
1004225	Qendra e Formimit Profesional Durrës	10	10	0	100%
1004226	Qendra e Formimit Profesional Korçë	7	6	-1	86%

1004227	Qendra e Formimit Profesional Elbasan	10	10	0	100%
1004228	Qendra e Formimit Profesional Gjirokastrë	8	7	-1	88%
1004229	Qendra e Formimit Profesional Vlorë	9	8	-1	89%
1004230	Qendra e Formimit Profesional Shkodër	10	9	-1	90%
1004231	Qendra e Formimit Profesional Fier	8	8	0	100%
1004232	Qendra e Formimit Profesional Lëvizëse	8	8	0	100%
1004233	Drejtoria Qendrore AKPA	82	76	-6	93%
1004234	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	30	30	0	100%
1004235	Shkolla "Kristo Isak", Berat	38	38	0	100%
1004236	Shkolla Profesionale "Stiliano Bandilli", Berat	41	41	0	100%
1004237	Shkolla "Nazmi Rushiti", Dibër	48	47	-1	98%
1004238	Shkolla "Beqir Çela", Durrës	120	111	-9	93%
1004239	Shkolla "Hysen Çela", Durrës	86	82	-4	95%
1004240	Shkolla Profesionale "Mihal Shahini", Elbasan	28	28	0	100%
1004241	Shkolla Profesionale "Petro Sota", Fier	69	69	0	100%
1004242	Shkolla Profesionale "Rakip Kryeziu", Fier	43	43	0	100%
1004243	Shkolla Profesionale Mekanike Lushnjë	56	56	0	100%
1004244	Shkolla Profesionale "Thoma Papano", Gjirokastrë	25	24	-1	96%
1004245	Shkolla Profesionale "Enver Qiraxhi", Pogradec	33	33	0	100%
1004246	Shkolla Profesionale "Hafzi Nela", Kukës	3	3	0	100%
1004247	Shkolla Profesionale "Kolin Gjoka", Lezhë	55	54	-1	98%
1004249	Shkolla Profesionale "Arben Broci", Shkodër	60	58	-2	97%
1004250	Shkolla Profesionale Pyjore "Kol Margjini", Shkodër	25	24	-1	96%
1004251	Shkolla Profesionale "Hamdi Bushati", Shkodër	56	56	0	100%
1004252	Shkolla Profesionale "Ndre Mjeda", Shkodër	30	30	0	100%
1004253	Shkolla Hoteleri-Turizëm, Tiranë	76	76	0	100%
1004254	Shkolla Profesionale Tekniko-Ekonomike, Tiranë	79	79	0	100%
1004255	Shkolla Profesionale "Karl Gega", Tiranë	97	92	-5	95%
1004256	Shkolla Elektrike "Gjergj Canco", Tiranë	108	104	-4	96%
1004257	Shkolla Profesionale Kamëz	136	135	-1	99%
1004258	Shkolla Profesionale "Agrobiznes", Kavajë	36	34	-2	94%
1004259	Shkolla Profesionale "Pavarësia", Vlorë	66	65	-1	98%
1004260	Shkolla Profesionale "Tregtare", Vlorë	35	34	-1	97%
1004261	Shkolla Profesionale "Antoni Athanasi", Sarandë	26	26	0	100%
1004262	Shkolla Profesionale Elbasan	124	124	0	100%
1004263	Shkolla e Shërbimeve Korçë	57	57	0	100%
1004264	Shkolla Teknike Korçë	68	68	0	100%
1004265	Shkolla Profesionale "Shën Jozefi Punëtor"	51	51	0	100%
TOTALI		3,129	2,979	-150	95%

PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI

Të gjitha programet buxhetore të Ministrisë, në respektim dhe promovim të plotë të barazisë gjinore, kanë përcaktuar tregues gjinorë konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm në nivel qëllimi dhe objektiv. Gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor (Ministria e Financave), nga të gjithë programet buxhetore janë përfshirë edhe disa tregues kyç të performancës që lidhen me buxhetimin mbi bazë gjinore dhe vlerat e synuara për këto tregues janë bërë pjesë e raporteve të monitorimit.

PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

1. Performanca financiare e programit buxhetor

Programi-Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi

Plani vjetor i rishikuar për vitin 2026 për Programin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” rezulton në 569,848 mijë lekë. Realizimi faktik progresiv për periudhën raportuese 4-mujore është 169,821 mijë lekë, ose 29.8% e planit të rishikuar. Krahësuar me planin fillestar prej 569,048 mijë lekë, plani i rishikuar paraqet një rritje prej 800 mijë lekë, e lidhur me ndryshime në shpenzimet korente të programit.

1. Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente, realizimi është në masën 32.0%.

Nga të cilat:

Shpenzime për personelin, ku përfshihen pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, janë realizuar në masën 33.2%. Konkretisht, artikulli 600 “Paga” është realizuar në masën 33.2%, ndërsa artikulli 601 “Sigurime shoqërore” në masën 33.4%.

Shpenzime për mallra dhe shërbime, janë realizuar në masën 31.6%.

Transferta korente të huaja, janë realizuar në masën 18.8%.

Transferta për buxhetet familjare dhe individë, janë realizuar në masën 19.6%.

- Shpenzime kapitale totale, realizimi është në masën 0.1%.

Nga të cilat:

Shpenzime kapitale me financim të brendshëm, realizimi është në masën 0.1%.

Shpenzime kapitale me financim të huaj, nuk parashikohen për këtë program.

2. Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm, realizimi është në masën 29.8%.
- Financimi i huaj, nuk parashikohet për këtë program.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Në këtë program janë parashikuar 2 produkte korente dhe 4 projekte investimi me plan të rishikuar në total 569,848 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar shpenzime në vlerën 169,821 mijë lekë, ose 29.8% e planit të rishikuar.

Totali i shpenzimeve korente – 32.0%

1. Akte ligjore/nënligjore të miratuara – realizimi financiar është 33.2%. Për këtë produkt, plani i rishikuar është 414,000 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik është 137,469 mijë lekë.
2. Staf i trajnuar – realizimi financiar është 27.9%. Për këtë produkt, plani i rishikuar është 115,848 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik është 32,297 mijë lekë.

Totali i shpenzimeve për investime – 0.1%

1. Rikonstrukcion i godinës për ish-ambientet e MZHETTS – realizimi është 100% për fondin e parashikuar në vitin 2026, me plan të rishikuar 55.2 mijë lekë dhe realizim faktik 55.2 mijë lekë.
2. Blerje pajisje TIK për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit – realizimi është 0%, me plan të rishikuar 10,800 mijë lekë.
3. Blerje automjetesh për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit – realizimi është 0%, me plan të rishikuar 21,944.8 mijë lekë.
4. Pajisje zyrash për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit – realizimi është 0%, me plan të rishikuar 7,200 mijë lekë.

Shpenzimet e programit për investime

Për Programin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, fondi i planifikuar për shpenzime kapitale është në vlerën 40,000,000 lekë. Deri në fund të periudhës raportuese janë realizuar shpenzime faktike në vlerën 55,200 lekë, ose vetëm 0.1% e planit. Ndërkohë, janë evidentuar obligime në vlerën 19,935,307 lekë, ndërsa fondet ende të disponueshme rezultojnë në vlerën 20,009,493 lekë.

Realizimi faktik i evidentuar lidhet vetëm me projektin “Rikonstrukcion i godinës për ish-ambientet e MZHETTS”, për të cilin është kryer likuidimi në vlerën 55,200 lekë. Ky projekt rezulton praktikisht i mbyllur për pjesën e mbetur të pagesës së vitit 2026.

Për projektin “Blerje pajisje TIK për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit”, me fond të planifikuar në vlerën 10,800,000 lekë, projekti rezulton në proces përgatitor/procedural. Sipas informacionit të raportuar, janë hartuar specifikimet teknike, është përllogaritur fondi limit dhe praktika është dërguar pranë AKSHI-së për vijimin e procedurës sipas kompetencës. Për këtë arsye, deri në periudhën raportuese nuk evidentohet ende realizim financiar.

Për projektin “Blerje automjetesh për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit”, me plan në vlerën 21,944,800 lekë, rezulton se fondet janë obliguar në vlerën 19,935,307 lekë, bazuar në urdhër-prokurimin nr. 2096, datë 27.04.2026. Gjithashtu, është likuiduar tarifa e OBP-së në vlerën 498,383 lekë. Kjo tregon se projekti ndodhet në një fazë të avancuar procedurale, por ende pa reflektim në realizimin financiar të vlerës kryesore të investimit.

Në këtë program evidentohet gjithashtu edhe linja “Fond i ngrirë”, në vlerën 7,200,000 lekë, e cila nuk paraqet realizim gjatë periudhës raportuese. Kjo linjë kërkon ndjekje të veçantë në vijim, me qëllim qartësimin e përdorimit të fondit, shmangien e vonësive procedurale dhe garantimin e ekzekutimit brenda vitit buxhetor.

Në tërësi, realizimi i investimeve për këtë program paraqitet në nivel shumë të ulët, kryesisht për shkak se projektet kryesore janë ende në fazë procedurale ose në pritje të vijimit nga strukturat përgjegjëse. Megjithatë, niveli i obligimeve, veçanërisht për projektin e blerjes së automjeteve, tregon se një pjesë e konsiderueshme e fondit është angazhuar dhe pritjet të reflektohet në realizim financiar në periudhat pasardhëse, me përfundimin e procedurave dhe likuidimin e pagesave përkatëse.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimi nga plani lidhet kryesisht me faktin se projektet kryesore të investimeve janë ende në fazë procedurale dhe nuk janë reflektuar plotësisht në realizim financiar. Për projektin e pajisjeve TIK, praktika është përcjellë pranë AKSHI-së pas përgatitjes së specifikimeve teknike dhe fondit limit, ndërsa për projektin e blerjes së automjeteve fondet janë obliguar në

vlerën 19,935,307 lekë, por pagesa kryesore nuk është kryer ende. Gjithashtu, për linjën “Fond i ngrirë”, në vlerën 7,200,000 lekë, janë në vijim procedurat për blerje pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara (OBP), ndaj ky fond nuk është reflektuar ende në realizim gjatë periudhës raportuese. Për rrjedhojë, niveli i ulët i realizimit prej 0.1% lidhet me ecurinë e procedurave, fazën e obligimit të fondeve dhe moslikuidimin ende të pagesave përkatëse.

Vlerësim i përgjithshëm

Në tërësi, realizimi i investimeve për Programin 01110 paraqitet në nivel shumë të ulët gjatë periudhës raportuese, me realizim faktik 55,200 lekë, ose 0.1% e planit buxhetor prej 40,000,000 lekë. Ky nivel realizimi nuk lidhet me mungesë të nevojës për investime, por kryesisht me faktin se projektet kryesore janë ende në fazë procedurale.

Nga ana tjetër, evidentimi i obligimeve në vlerën 19,935,307 lekë tregon se për një pjesë të konsiderueshme të fondeve procesi ka avancuar dhe pritet të reflektohet në realizim financiar në periudhat pasardhëse. Gjithashtu, për fondin në vlerën 7,200,000 lekë janë në vijim procedurat për blerje pranë OBP-së, çka kërkon ndjekje të afërt për të shmangur vonesa të mëtejshme.

Për periudhën në vijim rekomandohet monitorim i vazhdueshëm i ecurisë së procedurave, përshpejtim i hapave administrativë dhe koordinim me strukturat përgjegjëse, me qëllim që fondet e planifikuara të angazhohen dhe likuidohen brenda vitit buxhetor.

Programi-Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- **Shpenzime korente**, realizimi është në masën **10.0%**,

Nga të cilat:

shpenzime për paga, realizimi është në masën **20.8%**;

shpenzime për sigurime shoqërore, realizimi është në masën **28.3%**;

shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera, realizimi është në masën **21.8%**;

transferta korente të brendshme, realizimi është në masën **0.0%**;

transferta për buxhetet familjare dhe individë, realizimi është në masën **13.3%**.

- **Shpenzime kapitale totale**, realizimi është në masën **0.0%**,

nga të cilat shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën

0.0%, ndërsa financim i huaj nuk parashikohet për këtë program.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- **Financimi i brendshëm**, realizimi është në masën **9.7%**.

Financimi i huaj nuk parashikohet.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projektit

Totali i shpenzimeve korente – **10.0%**

Staf i trajnuar – **0.0%**

Shërbime dhe procese inovative të zbatuara – **27.5%**

Akte ligjore/nënligjore të miratuara – **0.0%**

Takime për përmirësimin e klimës së biznesit – **25.6%**

Kompani Start Up të mbështetura – **0.0%**

Totali i shpenzimeve për investime – **0.0%**

Fond i ngrirë – **0.0%**

Pajisje zyre AIE – **0.0%**

Pajisje kompjuterike AIE – **0.0%**

Shpenzimet e programit për investime

Për programin 01150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji”, plani buxhetor për shpenzime kapitale me financim të brendshëm është në shumën 17,000,000 lekë. Deri më datë 08.05.2026, nuk rezulton realizim financiar i reflektuar në tabelën e monitorimit, ndërkohë që fondet mbeten tërësisht të disponueshme.

Në këtë program përfshihet linja “Fond i ngrirë”, në vlerën 10,000,000 lekë, për të cilën evidentohet se janë hartuar specifikimet teknike, është përlogaritur fondi limit dhe praktika është përcjellë pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara (OBP). Gjithashtu, është likuiduar tarifa e OBP-së në vlerën 249,000 lekë, megjithëse ky veprim financiar nuk reflektohet ende si realizim në tabelën përkatëse. Për këtë fond, është në proces kërkesa drejtuar Ministrisë së Financave për ngurtësimin e fondit, me qëllim vijimin e procedurave sipas kuadrit përkatës.

Për Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës janë planifikuar 3,000,000 lekë për projektin “Pajisje zyre AIE” dhe 4,000,000 lekë për projektin “Pajisje kompjuterike AIE”. Të dy projektet rezultojnë ende me realizim 0.0% gjatë periudhës raportuese. Kjo lidhet me procesin e riorganizimit institucional të agjencive, sipas vendimmarrjes përkatëse të Këshillit të Ministrave, në kuadër të së cilës po kryhet kalimi i fondeve drejt agjencisë së re përgjegjëse.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani lidhen kryesisht me mosrealizimin e transfertave korente të brendshme, të parashikuara për mbështetjen e kompanive start-up, si dhe me mungesën e realizimit financiar të shpenzimeve kapitale gjatë periudhës raportuese. Gjithashtu, ndikim ka pasur ecuria e procedurave të prokurimit, procesi i ngurtësimit të fondit, si dhe kalimi i fondeve në vijim të riorganizimit institucional të agjencive. Realizimi financiar pritet të reflektohet në periudhat pasuese, pas përfundimit të hapave administrativë, buxhetorë dhe proceduralë në proces.

Programi-Mbështetje për Zhvillim Ekonomik

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 1.2% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Plan i fillestar i programit për vitin 2026 është në vlerën 518,325 mijë lekë, ndërsa plani vjetor i rishikuar është në vlerën 518,975 mijë lekë, duke reflektuar një shtesë neto prej 650 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 22.4%, ose në vlerën 116,446 mijë lekë.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente, realizimi është në masën rreth **22%**.
- Shpenzime kapitale totale, realizimi është në masën **26.5%**, nga të cilat:

Programi financohet kryesisht me financim të brendshëm, ndërkohë që në kapitullin 04 reflektohen shpenzime të lidhura me TVSH-në për projektet me financim të huaj.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – përbën pjesën kryesore të financimit të programit; realizimi është në **masën 98%**.
- Financimi i huaj/kapitull 04 – realizimi është në masën **35%**.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Në kuadër të shpenzimeve korente janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara – realizimi financiar është në masën rreth 6.9%;
- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh / kujdesi ndaj investitorëve – realizimi financiar është në masën rreth 32.6%;
- Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme – realizimi financiar është 0%;
- Studime fizibiliteti për projektet koncesionare/PPP – realizimi financiar është në masën rreth 25.3%;
- Kontrata koncesione/PPP të publikuara në regjistrin elektronik të koncesioneve – realizimi financiar është 0%;
- Shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të regjistrimit të licencave – realizimi financiar është në masën rreth 32.0%;
- Shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të regjistrimit të biznesit – realizimi financiar është në masën rreth 32.6%.

Realizimi më i lartë në shpenzimet korente lidhet kryesisht me produktet që mbështesin funksionimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, promovimin e investimeve nga AIDA, si dhe veprimtarinë e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve. Ndërkohë, disa produkte paraqesin realizim të ulët, për shkak të natyrës periodike të aktiviteteve, ecurisë së procedurave përkatëse dhe fazës në të cilën ndodhen skemat apo proceset mbështetëse.

Në artikullin 600 – Paga, realizimi është në vlerën 66,439 mijë lekë, ose rreth 31.4% të planit vjetor të rishikuar. Në artikullin 601 – Sigurime shoqërore, realizimi është në vlerën 10,932 mijë lekë, ose rreth 33.9%. Këto shpenzime lidhen me funksionimin e strukturave të programit dhe mbështesin kryerjen e detyrave institucionale nga aparati i ministrisë dhe institucionet e varësisë.

Në artikullin 602 – Mallra dhe shërbime, realizimi është në vlerën 24,898 mijë lekë, ose rreth 20.4% të planit vjetor të rishikuar. Ky zë mbulon shpenzimet operative të institucioneve, përfshirë shërbimet administrative, mirëmbajtjen, shpenzimet për promovim, organizim aktiviteteve, funksionim institucional dhe mbështetje për proceset teknike të lidhura me zhvillimin ekonomik.

Në artikullin 604 – Transferta korente të brendshme, plani vjetor i rishikuar është 100,000 mijë lekë, i lidhur me grantet për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Për periudhën raportuese nuk ka realizim financiar, pasi zbatimi i skemës varet nga përfundimi i procedurave përkatëse, vlerësimi i aplikimeve dhe miratimi i përfutuesve.

Shpenzimet e programit për investime

Investimet e programit janë planifikuar në vlerën 51,170 mijë lekë, nga të cilat 120 mijë lekë në artikullin 230 dhe 51,050 mijë lekë në artikullin 231. Për periudhën raportuese janë realizuar 13,572 mijë lekë, ose rreth 26.5% e planit të rishikuar.

Projektet kryesore të investimeve paraqiten si më poshtë:

- Blerje pajisje zyre – realizimi financiar është 0%;
- Pajisje audiovizuale – realizimi financiar është 0%;
- TVSH për projektet me financim të huaj – realizimi financiar është rreth 35%;
- Pajisje teknologjike/elektronike – realizimi financiar është 0%;
- Projekt preventiv rikonstruksion zyrash – realizimi financiar është 0%;
- Rikonstruksion i pjesshëm zyrash – realizimi financiar është 0%;
- Blerje pajisje kompjuterike – realizimi financiar është rreth 23.1%;
- Projekti EEN Albania – realizimi financiar është rreth 17.4%;
- Fond i ngrirë – realizimi financiar është 0%.

Realizimi i investimeve është mbështetur kryesisht nga pagesat për TVSH për projektet me financim të huaj, në vlerën 11,228 mijë lekë, si dhe nga projekti Blerje pajisje kompjuterike, në vlerën 1,823 mijë lekë. Gjithashtu, për projektin EEN Albania është realizuar vlera 521 mijë lekë.

Për disa projekte investimi nuk paraqitet ende realizim financiar, pasi ato lidhen me procedura prokurimi, përgatitje dokumentacioni, lidhje kontratash, marrje në dorëzim dhe likuidim të faturave përkatëse. Për këtë arsye, mungesa e realizimit në 4-mujorin e parë nuk nënkupton domosdoshmërisht mungesë ecurie, por lidhet me kalendarin procedural të zbatimit të investimeve.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar për Programin 04130 “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik” lidhen kryesisht me nivelin ende të ulët të realizimit të disa produkteve korente dhe kapitale gjatë periudhës raportuese, si dhe me ecurinë procedurale të projekteve të investimeve në institucionet zbatuese të programit.

Në shpenzimet korente, realizimi është ndikuar nga fakti se një pjesë e aktiviteteve kanë natyrë periodike dhe pritet të zhvillohen në muajt në vijim. Kjo vlen veçanërisht për produktin “Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, i cili ka plan të rishikuar 100,000 mijë lekë, por nuk paraqet ende realizim financiar për periudhën raportuese. Mungesa e realizimit në këtë fazë lidhet me ecurinë e procedurave për aplikim, vlerësim, përzgjedhje dhe miratim të përfituesve. Për këtë arsye, fondet e papërdorura nuk mund të konsiderohen si fonde të lira, pasi janë të lidhura me objektivin e programit për mbështetjen e sipërmarrjes dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Në produktet që lidhen me funksionimin e institucioneve dhe shërbimet ndaj biznesit, realizimi paraqitet më i qëndrueshëm, kryesisht në artikujt e pagave, sigurimeve shoqërore dhe një pjesë të shpenzimeve operative. Produktet “Shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të regjistrimit të biznesit”, “Shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të regjistrimit të licencave”, si dhe “Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh / kujdesi ndaj investitorëve” kanë reflektuar realizim financiar më të lartë krahasuar me produktet e tjera, pasi lidhen me veprimtari të vazhdueshme institucionale dhe me funksionimin e strukturave ekzistuese.

Për shpenzimet kapitale, realizimi financiar është i përqendruar kryesisht në disa projekte dhe institucione të veçanta. Realizimi më i lartë lidhet me projektin “TVSH për projektet me financim të huaj” pranë Aparatit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ku pagesat janë kryer në varësi të faturave të depozituara për likuidim. Për pjesën e mbetur, realizimi do të varet nga paraqitja e faturave të tjera, në përputhje me ecurinë e projekteve me financim të huaj. Për këtë arsye, fondet e mbetura në këtë projekt nuk konsiderohen fonde të lira, por janë të kushtëzuara nga dinamika e faturimit dhe likuidimit të TVSH-së.

Në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, realizimi i projekteve kapitale mbetet i ulët. Kjo lidhet kryesisht me faktin se një pjesë e fondeve kanë qenë me status “fond i ngrirë” dhe janë çngurtësuar gjatë periudhës raportuese, pas miratimit nga Ministria e Financave. Megjithatë, deri në periudhën e raportimit, këto fonde nuk kanë reflektuar ende realizim financiar, pasi kërkohet vijimi me hapat pasues proceduralë pas çngurtësimit. Gjithashtu, për projektin “Pajisje teknologjike/elektronike” nuk ka ende realizim financiar, pasi procedura ndodhet në fazë përgatitore, bazuar në nevojat e evidentuara për pajisje elektronike.

Për projektin “TVSH për projektet me financim të huaj” pranë AIDA-s, realizimi është shumë i ulët, pasi aktivitetet e projektit me financim të huaj priten të zhvillohen në periudhat pasuese. Për rrjedhojë, realizimi financiar pritet të rritet në varësi të zhvillimit të aktiviteteve dhe paraqitjes së faturave përkatëse për likuidim.

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve paraqet ecuri më të mirë në projektin “Blerje pajisje kompjuterike”, i cili është realizuar në masë të lartë gjatë periudhës raportuese. Ky realizim ka ndikuar pozitivisht në nivelin e përgjithshëm të realizimit të investimeve të programit, megjithëse vlera e projektit është relativisht e kufizuar në raport me totalin e investimeve të programit.

Në Qendrën Kombëtare të Biznesit, projektet kapitale nuk kanë reflektuar ende realizim financiar. Këto projekte përfshijnë “Projekt preventiv rikonstruksion zyrash”, “Rikonstruksion i pjesshëm zyrash”, “Blerje pajisje kompjuterike”, “Pajisje audiovizuale” dhe “Blerje pajisje zyre”. Mungesa e realizimit lidhet me faktin se projektet janë ende në fazë përgatitore dhe procedurale, përfshirë identifikimin e nevojave, hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin e fondit limit, si dhe ndjekjen e procedurave për projektet që varen nga institucione të tjera përgjegjëse, si AKSHI.

Në tërësi, devijimet nga plani në Programin 04130 lidhen kryesisht me:

- natyrën periodike të disa aktiviteteve korente;
- mungesën e realizimit financiar për skemën e granteve, e cila varet nga përfundimi i procedurave të aplikimit dhe përzgjedhjes së përfituesve;
- realizimin e TVSH-së në varësi të faturave të paraqitura për projektet me financim të huaj;
- fondet që kanë qenë me status “fond i ngrirë” dhe kërkojnë vijimin e procedurave pas çngurtësimit;
- procedurat e prokurimit dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik për projektet kapitale;
- faktin që një pjesë e projekteve të investimeve pritet të materializohen financiarisht në periudhat pasuese.

Për këtë arsye, realizimi financiar i programit pritet të rritet gjatë vitit, në varësi të përfundimit të procedurave të prokurimit, lidhjes së kontratave, dorëzimit të mallrave/shërbimeve, paraqitjes së faturave dhe likuidimit të tyre.

Programi - Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale

Fondet e akorduara për Programin 04160 “Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale” përbëjnë rreth 1% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Plani fillestar i programit për vitin 2026 është në vlerën 430,922 mijë lekë, ndërsa plani vjetor i rishikuar është në vlerën 432,212 mijë lekë, duke reflektuar një shtesë neto prej 1,290 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 31.2%, ose në vlerën 134,857 mijë lekë. Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese janë realizuar edhe 1,696 mijë lekë shpenzime korente nga të ardhurat jashtë limitit, duke e çuar totalin e shpenzimeve të programit në 136,552 mijë lekë.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente, realizimi është në masën rreth **32.6%**.
- Shpenzime kapitale totale, realizimi është në masën **0%**,

Programi financohet kryesisht me financim të brendshëm, ndërsa në kapitullin 06 reflektohen shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit, të lidhura kryesisht me shërbimet e akreditimit dhe metrologjisë.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën **31.2%**. Të ardhurat jashtë limitit,
- Kapitulli 06 – janë realizuar në vlerën 1,696 mijë lekë;
- Financimi i huaj – **nuk ka**.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Në kuadër të shpenzimeve korente, produktet kryesore të programit janë realizuar si më poshtë:

- Kalibrime dhe verifikime të mjeteve matëse – realizimi financiar është në masën rreth 27.8%;
- Anëtarësi me të drejta të plota në organizata ndërkombëtare – realizimi financiar është në masën rreth 44.5%;
- Inspektime për mbikëqyrjen e tregut në të gjithë territorin e vendit – realizimi financiar është në masën rreth 32.5%;
- Standarde evropiane dhe ndërkombëtare të adoptuara/miratuar si Standarde Shqiptare – realizimi financiar është në masën rreth 42.5%;
- Certifikata akreditimi të njohura në nivel ndërkombëtar – realizimi financiar është në masën rreth 39.3%.

Në artikullin 600 – Paga, realizimi është në vlerën 91,214 mijë lekë, ose rreth 32.2% e planit vjetor të rishikuar. **Në artikullin 601** – Sigurime shoqërore, realizimi është në vlerën 15,111 mijë lekë, ose rreth 31.9%. Këto shpenzime lidhen me funksionimin e strukturave përgjegjëse për akreditimin, standardizimin, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut.

Në artikullin 602 – Mallra dhe shërbime, realizimi është në vlerën 15,376 mijë lekë, ose rreth 25% e planit vjetor të rishikuar. Ky zë mbulon shpenzimet operative të institucioneve, përfshirë

shërbimet bazë, mirëmbajtjen, karburantin, kancelarinë, shpenzimet për udhëtime, shërbimet teknike dhe mbështetjen e veprimtarisë institucionale.

Në artikullin 605 – Transferta korente të huaja, realizimi është në vlerën 12,930 mijë lekë, ose rreth 61.6% e planit vjetor të rishikuar. Ky nivel realizimi lidhet kryesisht me pagesat për kuotat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare në fushën e akreditimit, standardizimit dhe metrologjisë.

Në artikullin 606 – Transferta për buxhetet familjare dhe individët, realizimi është në vlerën 225 mijë lekë, ose rreth 15.2% e planit vjetor të rishikuar. Ndryshimi i planit në këtë artikull lidhet me shtimin e fondeve për pagesa të fondit të veçantë dhe raste të tjera të parashikuara në aktet ligjore në fuqi.

Shpenzimet e programit për investime

Investimet e programit janë planifikuar në vlerën 18,000 mijë lekë, tërësisht me financim të brendshëm. Për periudhën raportuese nuk ka realizim financiar në shpenzimet kapitale.

Projektet kryesore të investimeve përfshijnë:

- Blerje pajisjesh për kompletimin e laboratorëve të DPM, në vlerën 16,000 mijë lekë;
- Blerje automjeti për ISHMT, në vlerën 2,000 mijë lekë.

Për projektin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, që lidhet me blerjen e pajisjeve për kompletimin e laboratorëve, janë evidentuar nevojat për pajisje laboratorike dhe janë hartuar specifikimet teknike përkatëse. Projekti ndodhet në fazën e marrjes së ofertave të vlefshme, me qëllim përcaktimin e fondit limit dhe vijimin e procedurës së prokurimit.

Për projektin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut “Blerje automjeti”, institucioni ka dërguar relacionin e grupit të punës pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, së bashku me specifikimet teknike për kryerjen e procedurës së prokurimit. Për këtë arsye, mungesa e realizimit financiar në 4-mujor lidhet me fazën procedurale të projektit dhe jo me mungesë nevojë për investim.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar për Programin 04160 lidhen kryesisht me natyrën periodike të shpenzimeve operative, me kalendarin e pagesave për kuotat e anëtarësimit ndërkombëtar, si dhe me ecurinë procedurale të projekteve kapitale.

Në shpenzimet korente, realizimi paraqitet në nivel relativisht të qëndrueshëm, veçanërisht për artikujt e pagave dhe sigurimeve shoqërore, të cilët ndjekin ecurinë normale të pagesave mujore të personelit. Shpenzimet operative në artikullin 602 paraqesin realizim më të ulët krahasuar me pagat dhe sigurimet, pasi një pjesë e tyre kryhen në varësi të nevojave konkrete të institucioneve, procedurave të prokurimit, kontratave në zbatim dhe kalendarit të shërbimeve të planifikuara gjatë vitit.

Në artikullin 605, realizimi më i lartë lidhet me pagesat për kuotat e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, të cilat kanë afate dhe detyrime specifike për pagesë. Për këtë arsye, ky artikull nuk ka shpërndarje të njëtrajtshme mujore, por realizohet në varësi të detyrimeve të institucioneve ndaj organizatave ku janë anëtare.

Në shpenzimet kapitale, realizimi është 0%, pasi projektet janë ende në fazë përgatitore dhe procedurale. Për projektin e pajisjeve laboratorike të DPM-së janë hartuar specifikimet teknike dhe po vijon procesi për përcaktimin e fondit limit, ndërsa për projektin e blerjes së automjetit

për ISHMT-në është përcjellë dokumentacioni pranë strukturës përgjegjëse për prokurimin e përqendruar. Për këtë arsye, realizimi financiar i investimeve pritet të reflektohet në periudhat pasuese, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, lidhjes së kontratave, marrjes në dorëzim të mallrave dhe likuidimit të faturave përkatëse.

Në tërësi, realizimi financiar i programit për periudhën raportuese paraqitet në nivel 31.2%, me ecuri më të mirë në shpenzimet korente dhe me realizim të ulët në investime për shkak të fazës procedurale të projekteve kapitale. Fondet e papërdorura në këtë fazë nuk mund të konsiderohen si fonde të lira, pasi lidhen me funksione të drejtpërdrejta të programit për mbikëqyrjen e tregut, standardizimin, metrologjinë, akreditimin dhe forcimin e infrastrukturës së cilësisë. Programi- Inspektimi ne Pune

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **0.7%** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Plan i vjetor i rishikuar për vitin 2026 është në vlerën 298,844 mijë lekë, nga të cilat 283,844 mijë lekë për shpenzime korente dhe 15,000 mijë lekë për shpenzime kapitale me financim të brendshëm. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 27%, ose në vlerën 81,945 mijë lekë.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente – realizimi është në masën rreth **29%**.
- Shpenzime kapitale totale – realizimi është në masën **0%**.

Programi financohet vetëm me **financim të brendshëm**.

Sipas burimit të financimit:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën **27%**.
- Financim i huaj – nuk ka.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Inspektimet e realizuara nga ISHPSHSH – **29%**

Realizimi i këtij produkti lidhet kryesisht me shpenzimet e personelit, të cilat përfaqësojnë pjesën më të madhe të buxhetit të programit. **Për artikullin 600** – Paga, realizimi është në vlerën 65,723 mijë lekë, ose 32% e planit vjetor të rishikuar, ndërsa **për artikullin 601** – Sigurime shoqërore, realizimi është në vlerën 10,973 mijë lekë, ose 26%. Këto shpenzime sigurojnë vijimësinë e funksionimit të institucionit dhe mbështesin ushtrimin e veprimtarisë inspektuese në nivel qendror dhe rajonal.

Në artikullin 602 – Mallra dhe shërbime të tjera, realizimi është në vlerën 5,133 mijë lekë, ose 15% e planit vjetor të rishikuar. Ky zë mbulon shpenzimet e nevojshme operative për funksionimin e institucionit, përfshirë energjinë, ujin, telefoninë, internetin, karburantin, mirëmbajtjen, shërbimet mbështetëse, si dhe dietat për inspektimet në terren.

Në artikullin 606 – Transferta për buxhetet familjare dhe individët, plani vjetor i rishikuar është 908 mijë lekë, ndërsa realizimi për periudhën raportuese është 116 mijë lekë, ose rreth 13%. Ndryshimi i planit në këtë artikull, në vlerën 860 mijë lekë, lidhet me fondin e akorduar për pagesa në rast daljeje në pension të punonjësve, raste sëmundjeje apo raste të tjera të ngjashme.

Shpenzimet e programit për investime

Investimet e programit janë planifikuar tërësisht me financim të brendshëm, në shumën **15,000 mijë lekë**, dhe përfshijnë projektet si më poshtë:

Blerje pajisje të ndryshme për zyra dhe mbrojtje ndaj zjarrit – **0%**

Blerje automjeti – **0%**

Blerje pajisje elektronike (kompjuterë/Laptop) – **0%**.

Për periudhën raportuese, shpenzimet kapitale nuk paraqesin realizim financiar. Megjithatë, mungesa e realizimit në këtë fazë nuk nënkupton mungesë ecurie të projekteve, pasi procedurat përkatëse janë në zhvillim.

Për projektin **“Blerje pajisje elektronike/kompjuterike”**, me plan **4,200 mijë lekë**, institucioni ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për nisjen e procedurës së prokurimit, e cila zhvillohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Ky projekt synon pajisjen e trupës inspektuese me pajisje informatike, në funksion të digjitalizimit të procesit inspektues dhe forcimit të kapaciteteve teknologjike të institucionit.

Për projektin **“Blerje pajisje të ndryshme për zyra dhe mbrojtje ndaj zjarrit”**, me plan **800 mijë lekë**, procedurat janë parashikuar të zhvillohen nga vetë institucioni, pasi fondi është brenda kufijve të blerjeve të vogla. Sipas informacionit të raportuar, janë kryer procedura për blerje mobiljesh/pajisjesh zyre dhe kondicionerësh, ndërsa likuidimi i faturave pritet të reflektohet në periudhat pasuese.

Për projektin **“Blerje automjeti”**, me plan **10,000 mijë lekë**, procedura e prokurimit zhvillohet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Projekti synon përmirësimin e kapaciteteve logjistike të Inspektoratit dhe mbështetjen e procesit inspektues në të gjithë territorin e vendit, në funksion të rritjes së eficiencës së punës në terren.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar lidhen kryesisht me nivelin e realizimit të shpenzimeve kapitale, të cilat për periudhën raportuese nuk kanë reflektuar ende pagesa faktike, si dhe me ritmin gradual të realizimit të shpenzimeve operative.

Në shpenzimet korente, realizimi ndikohet kryesisht nga ecuria normale e pagesave të personelit dhe nga fakti që institucioni ka ende vende vakante, çka ndikon në mosrealizimin e plotë të fondit të pagave dhe sigurimeve për periudhën raportuese. Ndërkohë, shpenzimet operative kanë natyrë periodike dhe realizohen në varësi të nevojave konkrete të institucionit, urdhrave të punës, inspektimeve në terren dhe kryerjes së procedurave përkatëse.

Për shpenzimet kapitale, devijimi lidhet me ecurinë procedurale të prokurimeve, përfshirë procedurat që zhvillohen nga AKSHI për pajisjet elektronike dhe nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara për automjetet. Për këtë arsye, realizimi financiar i investimeve pritet të reflektohet në periudhat pasuese, pas përfundimit të procedurave, lidhjes së kontratave, marrjes në dorëzim të mallrave dhe likuidimit të faturave përkatëse.

Në tërësi, realizimi financiar i programit për periudhën raportuese paraqitet në nivel **27%**, ndërsa ecuria e mëtejshme pritet të përmirësohet gjatë vitit, veçanërisht pas finalizimit të procedurave të prokurimit dhe pasqyrimin të pagesave për projektet e investimeve. Programi vijon të mbështesë funksionimin e ISHPSHSH-së dhe ushtrimin e veprimtarisë inspektuese, me fokus zbatimin e legjislacionit të punës, mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve dhe garantimin e kushteve të sigurta e të shëndetshme në punë.

Programi – Strehimi

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **3%** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën **6.2%**.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- **Shpenzime korente** – realizimi është në masën **10.3%**
- **Shpenzime kapitale totale** – realizimi është në masën **0%**,

nga të cilat:

- Shpenzime kapitale me financim të brendshëm – **0%**
- Shpenzime kapitale me financim të huaj – **0%**(nuk ka realizim)

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën 97.3%
- Financimi i huaj – 0% (nuk ka realizim)

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve

Në kuadër të shpenzimeve korente janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Bonusi i qirasë – 0%;
- Kreditë e reja – 0.3%;
- Kreditë ekzistuese që subvencionohen – 21.8%;
- Subvencionimi i qirasë për banorët e shpronësuar sipas VKM-së nr. 409, datë 15.06.2022 – 0%;
- Grant i menjëhershëm – 0%.

Në tërësi, realizimi i shpenzimeve korente të programit paraqitet në nivel të ulët për periudhën raportuese, pasi pjesa kryesore e realizimit lidhet me skemën e kredive ekzistuese që subvencionohen, ndërsa produktet e tjera nuk kanë reflektuar ende realizim financiar në 4-mujorin e parë.

Shpenzimet e programit për investime

Investimet e programit janë planifikuar tërësisht me financim të brendshëm, në shumën 500,000 mijë lekë, dhe përfshijnë kryesisht:

- Përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian;
- Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi;
- Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara;
- Adaptimin e godinave në pronësi të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore për strehim social.

Totali i investimeve është realizuar në masën **0%**.

Për periudhën raportuese, shpenzimet kapitale nuk paraqesin realizim financiar. Sipas informacionit të raportuar në ecurinë e investimeve, një pjesë e fondeve janë rialokuar së fundmi tek bashkitë, me qëllim vijimin dhe mbylljen e projekteve të nisura gjatë vitit 2025. Për këtë arsye, mungesa e realizimit financiar në 4-mujor lidhet me momentin e pasqyrimit të likuidimeve, ecurinë e raportimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, paraqitjen e dokumentacionit justifikues dhe likuidimin e situacioneve.

Në disa anekse të investimeve evidentohen projekte me emërtime të njëjta, por me kode të ndryshme produkti/projekti. Kjo lidhet me faktin se disa projekte janë trashëguar nga kode të mëparshme, ndërkohë që për vijimin e zbatimit dhe raportimit janë hapur kode të reja. Për këtë arsye, në analizë projektet trajtohen sipas natyrës së financimit dhe objektivit të tyre, duke shmangur dublimin e informacionit.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar lidhen kryesisht me realizimin e ulët të shpenzimeve kapitale, të cilat për periudhën raportuese nuk kanë reflektuar ende pagesa faktike, si dhe me ecurinë graduale të skemave korente të strehimit. Realizimi financiar i programit pritet të rritet në periudhat pasuese, në varësi të përfundimit të procedurave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, përcjelljes së dokumentacionit të plotë, paraqitjes së situacioneve për likuidim dhe pasqyrimin në kohë të fondeve të transferuara për projektet e strehimit social.

Programi-Arsimi i Mesëm (profesional)

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **11.8 %** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën **20%**.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente – realizimi është në masën 28.3%.
 - Sipas artikujve buxhetorë, realizimi paraqitet si më poshtë:
 - Pagat – realizimi është në masën rreth 31.5%.
 - Kontributet e sigurimeve shoqërore – realizimi është në masën rreth 30.7%.
 - Mallra dhe shërbime – realizimi është në masën rreth 18.0%.
 - Transferta për buxhetet familjare dhe individët – realizimi është në masën rreth 16.2%.
- Shpenzime kapitale totale – realizimi është në masën 0.7%, nga të cilat:
 - Shpenzime kapitale me financim të brendshëm – 0.7%
 - Shpenzime kapitale me financim të huaj – 0%

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën 99.2%.
- Financimi i huaj – realizimi është në masën 58.0%.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Shpenzime korente (produkte/aktivitete)

-
- Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara/miratuara – realizimi financiar paraqitet në masën rreth 2.9%.
 - Inspektime të ofruesve të AFP-së – realizimi financiar rezulton negativ, për shkak të sistemimeve/korrigjimeve në të dhënat faktike të raportuara.
 - Ofrues të AFP të mbështetur për sigurimin e cilësisë – realizimi financiar paraqitet në masën rreth 16.3%.
 - Mësues të trajnuar dhe atestuar – realizimi financiar paraqitet në masën rreth 50.4%.
 - Skeletkurikula, programe të kurseve të unifikuara dhe materiale mësimore të hartuara – realizimi financiar paraqitet në masën rreth 9.4%.
 - Standarde profesionale dhe kualifikimesh të miratuara – realizimi financiar paraqitet në masën rreth 11.3%.
 - Nxënës që përfitojnë subvencion për tekste mësimore – nuk rezulton realizim financiar në periudhën raportuese.
 - Bursa të përfituara nga nxënësit e arsimit profesional – realizimi financiar paraqitet në masën rreth 17.2%.
 - Nxënës që ndjekin shkollat e arsimit profesional – realizimi financiar paraqitet në masën rreth 30.5%.

Shpenzimet e programit për investime

Investimet kapitale paraqesin nivel të ulët realizimi në periudhën raportuese, ku pjesa më e madhe e projekteve rezulton pa realizim financiar faktik. Përjashtim bëjnë disa projekte specifike, si:

- TVSH për projekte të ndryshme (18BS314) – realizimi është në masën 100.0%.
- Kolaudim për Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz, në kuadër të projektit “Fond for VET and Employment” (24AB513) – realizimi është në masën rreth 59.0%.

Ndërkohë, projektet e tjera të investimeve, përfshirë:

- Pajisje zyre AKAFPK (18AY502);
- Laboratorë, pajisje dhe makineri për repartet e praktikave profesionale (18AY503);
- Blerje pajisjesh digjitale për sistemin e AFP-së (18AY506);
- Ndërtim/rikonstruksion i repartit të praktikave profesionale në shkollën “Karl Gega”, Tiranë (18AY639);
- Rikonstruksion i godinës së shkollës Kamëz (24AB501);
- Rikonstruksion i godinës së shkollës mekanike “Hasan Gina”, Lushnje (24AB502);
- Rikonstruksion/ndërtim i ri i shkollës “Pavarësia”, Vlorë (24AB503);
- Rikonstruksion i konviktit Cërrik (24AB504);
- Rikonstruksion i shkollës “Bajram Curri”, Kukës (24AB505);
- Rikonstruksion i shkollës “Enver Qiraxhi”, Pogradec (24AB506);
- Rikonstruksion/ndërtim i shkollës teknike, Korçë (24AB507);
- Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës “Kolin Gjoka”, Lezhë (24AB508);
- Rikonstruksion i shkollës “Arben Broci” (24AB509);
- Ndërtim/rikonstruksion i shkollës “Hamdi Bushati”, Shkodër (24AB510);
- Ndërtim i ri i shkollës “Karl Gega”, Tiranë (24AB511);
- Blerje programesh, implementim sistemesh digjitale, mirëmbajtje dhe licenca (24AB401),

nuk paraqesin realizim financiar faktik në periudhën raportuese.

Investime me financim të huaj

Në program janë parashikuar edhe projekte që lidhen me mbështetjen e arsimit dhe formimit profesional, si:

- Skills for Job; Mbështetje e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit; Fondi Arsimor 2016 KfW; PROSEED Arsimit Profesional; ADULT LEARNING AGENDA; EPALE; FOODATOURISM; DIGIVET; B4CVET; DigiGreenVET; CRAFTS-VET; CyberFort; Alliance; Circular Tourism; EmpowerVET.

Për këto projekte, në periudhën raportuese nuk rezulton realizim financiar faktik, çka tregon se zbatimi financiar i tyre pritet të materializohet në periudhat pasuese, në varësi të ecurisë së procedurave, kontraktimeve dhe kalendarit të zbatimit të projekteve.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimi kryesor nga plani lidhet me nivelin shumë të ulët të realizimit financiar të projekteve kapitale, ku deri në datën 08.05.2026 realizimi është vetëm 1.0% e planit vjetor. Pavarësisht këtij niveli të ulët financiar, nga informacioni shpjegues rezultojnë se për një pjesë të projekteve ka ecuri procedurale ose fizike, e cila ende nuk është reflektuar në shpenzimet faktike të periudhës.

Për disa projekte, vonesat lidhen me fazat përgatitore të zbatimit, si hartimi i specifikimeve teknike, përllogaritja e fondit limit dhe kryerja e studimit të tregut. Këto elemente kanë ndikuar në mosnisen e procedurave të prokurimit ose në shtyrjen e realizimit financiar për periudhat në vijim.

Për projektet infrastrukturore, një pjesë e devijimeve lidhet me pritjen e miratimit të lejeve përkatëse nga AZHT, ndërsa në raste të veçanta janë evidentuar problematika të lidhura me dokumentacionin e pronësisë, si në rastin e shkollës “Arben Broci” në Shkodër. Këto faktorë kanë ndikuar në vonesat në avancimin procedural dhe financiar të projekteve përkatëse.

Ndërkohë, për disa projekte me peshë të rëndësishme, si “Industriale Pavarësia” në Vlorë dhe “Bajram Curri” në Kukës, rezultojnë se punimet vijojnë normalisht dhe janë paraqitur situacione për likuidim. Megjithatë, këto situacione ende nuk janë reflektuar në realizimin financiar të tabelës, çka tregon se realizimi faktik pritet të rritet në periudhat pasuese, pas kryerjes së likuidimeve përkatëse.

Në këtë kontekst, niveli i ulët i realizimit financiar nuk reflekton domosdoshmërisht mungesë totale ecurie të projekteve, por evidenton vonesat në kalimin nga faza procedurale/fizike në pasqyrim financiar. Megjithatë, duke qenë se programi 09240 ka peshën më të madhe në totalin e fondeve kapitale të raportuara, niveli aktual i realizimit përbën risk të rëndësishëm për arritjen e objektivave të vitit buxhetor.

Rritja e realizimit në muajt në vijim do të varet nga zhblllokimi i këtyre problematikave dhe nga përshpejtimi i procesit të pagesave për punimet apo shërbimet e kryera.

Një pjesë e shpenzimeve korrente të programit lidhet drejtpërdrejt me kalendarin shkollor dhe për këtë arsye nuk paraqet ecuri të plotë financiare në këtë fazë të vitit. Kjo vlen veçanërisht për zëra si subvencionimi i teksteve mësimore, bursat dhe mbështetjet tjera që realizohen në funksion të vitit shkollor dhe kalendarit të pagesave përkatëse. Për rrjedhojë, realizimi i ulët në këto produkte nuk reflekton domosdoshmërisht moszbatim të aktivitetit, por zhvendosje të realizimit financiar në periudhat që lidhen me zhvillimin e procesit mësimor.

Nga ana e MEI-së janë ndërmarrë masa për ndjekjen e problematikave të evidentuara, me qëllim që proceset të jenë më ndërevepruese ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe institucioneve zbatuese siç janë bashkitë. Në mënyrë të veçantë, është kërkuar ndjekje më e afërt për ecurinë e bursave të arsimit të mesëm profesional, me qëllim vijimin e procesit dhe shmangien e vonesave në trajtimin e përfutësve.

Në këtë kontekst, niveli i ulët i realizimit financiar në disa produkte nuk reflekton domosdoshmërisht mungesë totale ecurie të produkteve, por evidenton ndikimin e kalendarit shkollor në disa kategori shpenzimesh.

Si përmbledhje mund të shprehemi se rritja e realizimit në muajt në vijim do të varet nga zhblllokimi i këtyre problematikave, nga përshpejtimi i procesit të pagesave për punimet apo shërbimet e kryera, si dhe nga zbatimi i kalendarit të pagesave që lidhen me vitin shkollor.

Programi -Tregu i Punës

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth **12 %** të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën **21.7%**.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korente – realizimi është në masën 23.1%.
- Shpenzime kapitale totale – realizimi është në masën 0, nga të cilat:
 - Shpenzime kapitale me financim të brendshëm – 0%
 - Shpenzime kapitale me financim të huaj – 0%

Sipas burimit të financimit, realizimi i programit është mbështetur tërësisht nga financimi i brendshëm, ndërsa projektet me financim të huaj nuk kanë pasur realizim financiar gjatë periudhës raportuese dhe paraqitet si më poshtë:

- Financimi i brendshëm – realizimi është në masën 0%.
- Financimi i huaj – realizimi është në masën 0%.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projekteve

Në kuadër të shpenzimeve korente janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Ndërmjetësime të realizuara nga Zyrat e Punësimit AKPA – 33.3%;
- Kursantë në formimin profesional sipas VKM nr. 646, datë 5.10.2022 – 6.4%;
- Të punësuar/të trajnuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit – 55.9%;
- Persona të trajtuar me pagesë papunësie – 28.8%;
- Të rinj përfitues të nismës Garancia Rinore – 38.5%;
- Të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional Publik – 29.8%;
- Leje pune për shtetas të huaj, raportime statistikore, financiare dhe procedura prokurimi – 31.3%;
- Plan i rritjes – 1.5%.

Në tërësi, shpenzimet korente të programit paraqiten me realizim të moderuar për periudhën raportuese. Realizimi është mbështetur kryesisht nga produktet që lidhen me programet e nxitjes së punësimit, pagesën e papunësisë, ndërmjetësimin në tregun e punës dhe formimin profesional. Ndërkohë, disa produkte paraqesin realizim të ulët, veçanërisht ato që lidhen me kurset e formimit profesional dhe Planin e Rritjes, për të cilat realizimi pritet të rritet në periudhat pasuese në varësi të ecurisë së procedurave dhe zbatimit të aktiviteteve të planifikuara.

Shpenzimet e programit për investime

Investimet e programit janë planifikuar në shumën totale prej 281,000 mijë lekë, nga të cilat 231,000 mijë lekë me financim të brendshëm dhe 50,000 mijë lekë me financim të huaj. Për periudhën raportuese, shpenzimet kapitale nuk paraqesin realizim financiar.

Investimet me financim të brendshëm përfshijnë kryesisht:

- Ndërtimin e Kampusit të QFP-së;
- Studim-projektimet për rikonstruksione;
- Blerjen e kabineteve për kurse formimi profesional;
- Rikonstruksione të zyrave të punësimit dhe qendrave të formimit profesional;
- Blerje pajisjesh zyre dhe pajisjesh kompjuterike/elektronike.

Sipas informacionit të raportuar për ecurinë e investimeve, projekti “Ndërtim i Kampusit të QFP-së” është në proces zbatimi, bazuar në kontratën nr. 2215/3, datë 26.12.2024. Për këtë projekt është evidentuar nevoja për avancimin e fondeve në muajin maj 2026, me qëllim likuidimin e faturës nr. 8/2026, datë 23.04.2026, ndaj kompanisë zbatuese, në shumën 32,337.7 mijë lekë.

Projekti “Blerje pajisje zyre” është në fazë përgatitore, me hartim të specifikimeve teknike dhe dërgim të materialeve pranë OBP-së për realizimin e procedurës së prokurimit. Projekti “Studim-projektim” lidhet me rikonstruksin dhe ndërtimin e Qendrës Multifunkionale pranë QFP nr. 4, si dhe rikonstruksin e QFP Durrës, dhe ndodhet në fazën e përgatitjes së dokumentacionit teknik. Ndërkohë, projekti “Blerje kabinete për kurse formimi profesional” është në fazë përgatitore, ku po kryhet analiza e nevojave për kabinete në QFP dhe përllogaritja e fondit limit.

Projektet me financim të huaj, me plan total 50,000 mijë lekë, nuk kanë pasur realizim financiar gjatë periudhës raportuese. Sipas informacionit të raportuar, sic edhe jeni ne dijeni, projektet kanë marrë së fundmi kodet përkatëse në sistemin AFMIS, janë njoftuar donatorët dhe pritët akordimi i fondeve, si dhe fillimi i procedurave sipas planit të buxhetit të miratuar për secilin projekt.

Të ardhurat jashtë limitit

Përveç fondeve buxhetore të programit, gjatë periudhës raportuese janë realizuar edhe shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit, në shumën totale 16,153 mijë lekë, nga të cilat 10,603 mijë lekë shpenzime korente dhe 5,550 mijë lekë shpenzime kapitale. Këto shpenzime lidhen kryesisht me të ardhurat e realizuara nga Qendrat e Formimit Profesional Publik, të përdorura për nevojat e kurseve profesionale, si dhe me financime projektesh që ndjekin skemën e plotë të thesarit. Shpenzimet korente janë përdorur kryesisht për materiale për kurset e profesionit dhe aktivitete promovuese, ndërsa shpenzimet kapitale janë orientuar për pajisje për kabinete dhe mjete në funksion të zbatimit të aktiviteteve të programit.

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani vjetor i rishikuar lidhen kryesisht me mungesën e realizimit financiar në shpenzimet kapitale gjatë 4-mujorit të parë, si dhe me ritmin gradual të zbatimit të disa produkteve korente. Për investimet, mosrealizimi financiar lidhet me fazën procedurale në të cilën ndodhen projektet, përfshirë hartimin e specifikimeve teknike, përllogaritjen e fondit

limit, ndjekjen e procedurave pranë OBP-së, si dhe varësinë nga ecuria e projekteve me financim të huaj.

Në periudhat pasuese pritet rritje e realizimit financiar, veçanërisht nëse finalizohen procedurat e prokurimit, paraqiten situacionet për projektet në zbatim, akordohen fondet e projekteve me financim të huaj dhe përshpejtohet zbatimi i produkteve që lidhen me formimin profesional, nxitjen e punësimit, Planin e Rritjes dhe mbështetjen financiare nga ndryshimi i pagës minimale.

Programi-Sigurimet shoqërore

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 5% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MEI-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 95.2%

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

- **Shpenzime korente**, realizimi është në masën **39.1%** të planit vjetor të rishikuar, nga të cilat:
 - shpenzime për paga, realizimi është në masën **0.0%**;
 - shpenzime për sigurime shoqërore, realizimi është në masën **0.0%**;
 - shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera, realizimi është në masën **0.0%**;
 - transferta korente të brendshme, realizimi është në masën **39.1%**.
- **Shpenzime kapitale totale**, nuk janë parashikuar për këtë program në aneksin e programit, nga të cilat shpenzime kapitale me financim të brendshëm nuk janë parashikuar, ndërsa financim i huaj nuk parashikohet për këtë program.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- **Financimi i brendshëm**, realizimi është në masën **39.1%** të planit vjetor të rishikuar. Financimi i huaj nuk parashikohet.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve/projektit

Totali i shpenzimeve korente – 39.1%

Transferte buxhetore për të mbuluar diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve të skemës së pensioneve publike – 32.6%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për trajtim të veçantë të punonjësve të nëntokës – 23.5%
Përfitime të llogaritura e të shpërndara për sigurimin suplementar të personave me statusin “Profesor” – 23.5%
Përfitime të llogaritura e të shpërndara për sigurimin shtetëror suplementar – 23.5%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për sigurimin suplementar të ish-policëve – 23.5%
Përfitime të llogaritura e shpërndara për sigurimin suplementar për persona me statusin “Metalurg” – 23.5%
Përfitime të llogaritura e shpërndara për sigurimin suplementar për persona me statusin “Naftëtar” – 23.5%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për programin e Kompensimit të Çmimeve – 31.0%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për programin e pensioneve të posaçme shtetërore – 31.0%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për shpërblime për Pensionet e Veteranëve – 31.0%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për shpërblime për Invalidët e Punës – 31.0%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për të ardhurat e pensionistëve – 31.0%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime për pensionet sociale – 31.0%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për kompensime mbi statusin “Dëshmor i Atdheut” – 23.5%
Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë për shpenzime varrimi – 23.5%
Akte ligjore/nënligjore të hartuara – 0.0%

Arsyet e devijimeve nga plani

Devijimet nga plani lidhen kryesisht me natyrën e programit, i cili mbështetet në transferta për financimin e skemës së sigurimeve shoqërore, përfitimeve suplementare, kompensimeve dhe programeve të veçanta. Realizimi i transfertave ndjek ecurinë faktike të numrit të përfituesve, të drejtave të lindura gjatë periudhës, si dhe ritmin e pagesave për pensione, kompensime, shtesa dhe trajtime të veçanta.

Në tërësi, realizimi financiar i programit paraqitet në nivel të qëndrueshëm, pasi shpenzimet për përfitime janë realizuar sipas planit.

2. Performanca jo-financiare e programit buxhetor

Programi -Tregu i Punës

Programi 10550 “Tregu i Punës” synon identifikimin dhe zbatimin e politikave nxitëse të punësimit në vend, zhvillimin e formimit profesional të forcës së punës, si dhe rritjen e mundësive për punë cilësore dhe aftësim gjatë gjithë ciklit të jetës. Programi fokusohet në përmirësimin e shërbimeve të punësimit, rritjen e ndërmjetësimeve, këshillimin dhe orientimin për karrierë, targetimin e grupeve në nevojë për punë, përshtatjen e kurseve të formimit profesional me kërkesat e tregut të punës, si dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të migrimit sipas standardeve të BE-së.

Në nivel qëllimi, për periudhën raportuese, treguesit kryesorë të performancës lidhen me përqindjen e vendeve të lira të punës të plotësuara, përqindjen e punëkërkuesve të papunë të mbajtur në punë pas përfundimit të programit të nxitjes, si dhe përqindjen e punëkërkuesve të punësuar pas përfundimit të formimit profesional. Këta tregues kanë objektiva vjetore përkatësisht 43%, 64% dhe 73%, ndërsa vlerësimi i plotë i tyre pritet të reflektohet në periudhat pasuese, pas konsolidimit të të dhënave mbi përfituesit dhe rezultatet e programeve.

Në kuadër të objektivit për përmirësimin e shërbimeve të punësimit dhe mbështetjen e grupeve në nevojë, gjatë periudhës janar–prill 2026 janë evidentuar rezultate pozitive për disa kategori prioritare. Për punësimin e punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara janë realizuar 199 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 290 përfituesish, duke arritur rreth 69% të objektivit vjetor. Ky tregues paraqet ecuri të mirë për 4-mujorin e parë dhe reflekton orientimin e programit drejt përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.

Për punësimin e punëkërkuesve të papunë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian janë realizuar 581 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 749 përfituesish, ose rreth 78% të objektivit vjetor. Ky nivel realizimi tregon performancë të mirë për periudhën raportuese dhe dëshmon efektivitetin e ndërmjetësimit dhe masave të nxitjes së punësimit për këtë kategori.

Për punësimin e punëkërkuesve të rinj, të grupmoshës 16–29 vjeç, janë evidentuar 2,236 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 6,200 përfituesish, duke arritur rreth 36% të objektivit vjetor. Ky tregues paraqet ecuri të moderuar për periudhën 4-mujore, ndërsa pritet që zbatimi i masave që lidhen me punësimin e të rinjve dhe Garancinë Rinore të intensifikohet gjatë muajve në vijim.

Për punësimin e punëkërkuesve të papunë nga ndihma ekonomike janë realizuar 703 përfitues, kundrejt planit vjetor të rishikuar prej 1,580 përfituesish, ose rreth 44% të objektivit vjetor. Ky tregues paraqet ecuri të kënaqshme për periudhën raportuese dhe reflekton orientimin e shërbimeve të punësimit drejt kategorive që kanë nevojë për riintegrim në tregun e punës.

Për punësimin e punëkërkesve të papunë nga pagesa e papunësisë janë realizuar 40 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 1,350 përfituesish, ose rreth 3% të objektivit. Niveli i ulët i realizimit tregon nevojën për ndjekje më të afërt të kësaj kategorie gjatë periudhave pasuese, me qëllim rritjen e përfshirjes së përfituesve të pagesës së papunësisë në shërbimet e ndërmjetësimit dhe programet e nxitjes së punësimit.

Në drejtim të formimit profesional, treguesi “Punëkërkes të papunë që regjistrohen/certifikohen në kurset e formimit profesional” rezulton me 2,710 përfitues, kundrejt planit vjetor të rishikuar prej 13,300 përfituesish, duke reflektuar një realizim prej rreth 20%. Ky nivel lidhet me ciklin e zhvillimit të kurseve të formimit profesional, regjistrimet, përfundimin e kurseve dhe certifikimin e përfituesve, të cilat pritet të reflektohen më gjerësisht gjatë pjesës tjetër të vitit.

Në nivel produktesh, shërbimet e punësimit kanë vijuar të mbështesin ndërmjetësimin, këshillimin dhe orientimin e punëkërkesve. Për produktin “Ndërmjetësime të realizuara nga Zyrat e Punësimit AKPA” janë realizuar 5,540 ndërmjetësime, kundrejt planit vjetor prej 22,930, ose rreth 24% e objektivit vjetor në sasi. Në terma financiarë, ky produkt është realizuar në masën 33%, duke treguar vijimësi të ofrimit të shërbimeve të punësimit gjatë periudhës raportuese.

Për produktin “Të punësuar/të trajnuar në programet e nxitjes së punësimit” janë realizuar 1,959 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 2,015, ose rreth 97% të objektivit vjetor në sasi. Ky është një nga treguesit me performancën më të lartë jo-financiare në program dhe tregon ecuri shumë të mirë të programeve aktive të tregut të punës gjatë 4-mujorit të parë.

Për produktin “Të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional Publik” janë realizuar 4,496 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 13,300, ose rreth 34% të objektivit vjetor. Ky tregues paraqet ecuri të pranueshme për periudhën raportuese, duke marrë në konsideratë se kurset e formimit profesional zhvillohen me cikle dhe realizimi i plotë pritet të rritet në vijim.

Për produktin “Të rinj përfitues të nismës Garancia Rinore” janë realizuar 354 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 612, ose rreth 58% të objektivit vjetor. Ky tregues paraqet ecuri pozitive, duke reflektuar zbatimin e masave për mbështetjen e të rinjve në drejtim të punësimit, arsimit dhe formimit profesional.

Për produktin “Kursantë në formimin profesional sipas VKM nr. 646, datë 05.10.2022” janë realizuar 61 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 604, ose rreth 10% të objektivit. Niveli i ulët i realizimit lidhet me ecurinë graduale të regjistrimeve dhe zhvillimit të kurseve në këtë skemë, ndaj kërkohet ndjekje e mëtejshme për rritjen e pjesëmarrjes gjatë periudhës pasuese.

Për produktin “Leje pune për shtetas të huaj, raportime statistikore, financiare dhe procedura prokurimi” janë realizuar 9,984 raste/procedura, kundrejt planit vjetor prej 10,000, ose rreth 100% të objektivit. Ky tregues paraqet realizim shumë të lartë dhe tregon ecuri të plotë të funksioneve administrative dhe mbështetëse të programit për periudhën raportuese.

Për produktin “Persona të trajtuar me pagesë papunësie” janë trajtuar 2,800 persona, në përputhje me planin vjetor prej 2,800 personash, duke realizuar 100% të objektivit sasi. Ky tregues tregon se mbështetja me të ardhura për personat e papunë është garantuar në mënyrë të plotë për periudhën raportuese.

Për produktin “Punësime/trajnime nga programet aktive të tregut të punës – Plani i Rritjes” janë realizuar 383 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 2,015, ose rreth 19% të objektivit. Ky produkt paraqitet në fazë fillestare zbatimi dhe pritet të ketë rritje në muajt në vijim, në varësi të ecurisë së masave të parashikuara në Agjendën Kombëtare të Reformave.

Në komponentin e investimeve, programi përfshin ndërhyrje për ndërtimin e Kampusit të QFP-së, blerjen e kabineteve për kurse formimi profesional, studim-projektimet, blerjen e pajisjeve zyre dhe projektet me financim të huaj. Për periudhën raportuese, këto produkte nuk paraqesin

realizim sasior dhe financiar të reflektuar në anekset e performancës. Megjithatë, disa prej tyre janë në fazë përgatitore ose procedurale, si përgatitja e dokumentacionit teknik, hartimi i specifikimeve, përllogaritja e fondit limit dhe ndjekja e procedurave pranë strukturave përkatëse.

Në përfundim, performanca jo-financiare e programit 10550 “Tregu i Punës” për periudhën janar–prill 2026 paraqitet pozitive për disa tregues kyç, veçanërisht për punësimin e punëkërkuesve nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, për personat me aftësi të kufizuara, përfituesit e Garancisë Rinore, trajtimin me pagesë papunësie dhe programet e nxitjes së punësimit. Ndërkohë, treguesit që lidhen me formimin profesional sipas VKM nr. 646, punësimin e përfituesve nga pagesa e papunësisë, Planin e Rritjes dhe investimet paraqesin realizim më të ulët dhe kërkojnë ndjekje më të afërt gjatë periudhave pasuese. Rritja e performancës pritet të varet nga intensifikimi i programeve aktive të punësimit, zgjerimi i kurseve të formimit profesional dhe përsheptimi i procedurave të investimeve të planifikuara.

Për programin - Sigurimet Shoqërore

Performanca e programit 10220 “Sigurimet Shoqërore” paraqitet e lidhur me financimin e skemës së pensioneve publike, skemave suplementare, kompensimeve dhe trajtimeve të veçanta. Në nivel produktesh, realizimi financiar dhe fizik ndjek kryesisht dinamikën e numrit faktik të përfituesve dhe pagesave të kryera gjatë periudhës raportuese.

Transferte buxhetore për të mbuluar diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve të skemës së pensioneve publike – Për këtë produkt, plani vjetor i rishikuar parashikon 754,647 përfitues, ndërkohë që fakti i periudhës rezulton 761,402 përfitues, pra mbi planin e parashikuar. Në terma financiarë, nga plani vjetor prej 14,065,155,000 lekë, janë realizuar 4,589,936,000 lekë, ose rreth 32.6%.

Akte ligjore/nënligjore të hartuara – Për këtë produkt është planifikuar hartimi i 1 akti, i cili rezulton i realizuar gjatë periudhës raportuese. Në aspektin financiar, megjithëse është parashikuar fondi prej 7,070,000 lekë, nuk rezulton realizim financiar gjatë periudhës.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për kompensime për “Trajtim i veçantë i punonjësve të nëntokës” – Plan i vjetor i rishikuar është 14,618 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 14,953 përfitues, duke treguar realizim mbi planin fizik. Në aspektin financiar, janë realizuar 203,987,000 lekë.

Përfitime të llogaritura e të shpërndara për sigurimin suplementar të personave me statusin “Profesor” – Plan i vjetor i rishikuar është 1,117 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 1,101 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 50,331,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 214,547,000 lekë.

Përfitime të llogaritura e të shpërndara për sigurimin shtetëror suplementar – Plan i vjetor i rishikuar është 4,650 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 4,581 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 256,917,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 1,095,168,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për sigurimin suplementar të ish-policëve – Plan i vjetor i rishikuar është 10,517 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 10,326 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 2,933,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 12,504,000 lekë.

Përfitime të llogaritura e të shpërndara për sigurimin suplementar për persona me statusin “Metalurg” – Plan i vjetor i rishikuar është 2,022 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 1,957 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 15,297,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 65,206,000 lekë.

Përfitime të llogaritura e të shpërndara për sigurimin suplementar për persona me statusin “Naftëtar” – Plan i vjetor i rishikuar është 10,437 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton

10,289 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 148,438,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 632,752,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për programin e kompensimit të çmimeve – Plani vjetor i rishikuar është 408,401 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 394,758 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 1,361,587,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 4,793,229,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për programin e pensioneve të posaçme shtetërore – Plani vjetor i rishikuar është 280 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 273 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 99,503,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 321,247,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për shpërblime për pensionet e veteranëve – Plani vjetor i rishikuar është 508 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 501 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 7,301,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 23,572,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për shpërblime për invalidët e punës – Plani vjetor i rishikuar është 341 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 345 përfitues, duke tejkaluar lehtë planin fizik. Në aspektin financiar, janë realizuar 12,930,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 41,744,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për kompensime për të ardhurat e pensionistëve – Plani vjetor i rishikuar është 234,171 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 231,713 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 997,197,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 3,219,469,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për kompensime për pensionet sociale – Plani vjetor i rishikuar është 2,206 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 1,916 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 69,708,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 225,057,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për kompensime mbi statusin “Dëshmor i Atdheut” – Plani vjetor i rishikuar është 303 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 307 përfitues, pra mbi planin fizik. Në aspektin financiar, janë realizuar 6,084,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 25,933,000 lekë.

Përfitime të llogaritura dhe të shpërndara për trajtimin e veçantë për shpenzime varrimi – Plani vjetor i rishikuar është 25,055 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 8,416 përfitues. Në aspektin financiar, janë realizuar 44,598,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 190,109,000 lekë. Ky produkt ndikohet nga natyra specifike e përfitimit dhe nga rastet faktike të ndodhura gjatë periudhës raportuese.

Shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit – Plani vjetor i rishikuar është 69,641 përfitues, ndërsa fakti i periudhës rezulton 71,197 përfitues, duke tejkaluar planin fizik. Në aspektin financiar, janë realizuar 888,553,000 lekë, kundrejt planit vjetor prej 2,868,701,000 lekë.

Në përmbledhje, produktet e programit 10220 “Sigurimet Shoqërore” paraqesin ecuri të qëndrueshme në drejtim të mbulimit të përfituesve dhe vijimit të pagesave. Për disa produkte, si skema e pensioneve publike, trajtimi i veçantë i punonjësve të nëntokës, invalidët e punës, kompensimet mbi statusin “Dëshmor i Atdheut” dhe shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit, numri faktik i përfituesve rezulton më i lartë se plani i rishikuar. Ndërkohë, për disa produkte të tjera, veçanërisht pensionet sociale dhe trajtimi për shpenzime varrimi, realizimi fizik paraqitet më i ulët se plani, për shkak të dinamikës faktike të përfituesve dhe natyrës së veçantë të këtyre pagesave.

Programi - Strehimi

Programi 06190 “Strehimi” synon ofrimin e alternativave të përshtatshme dhe të përballueshme për familjet dhe individët që nuk arrijnë të përballojnë kostot e tregut të banesave, në përputhje

me politikat sociale të strehimit dhe objektivin afatgjatë për adresimin e nevojave të 35,000 individëve/familjeve deri në vitin 2030.

Për periudhën janar–prill 2026, treguesi “Numri i familjeve që kanë përmirësuar kushtet e jetesës si rezultat i përfitimit nga programet sociale të strehimit” rezulton në 27,132 familje, kundrejt planit vjetor të rishikuar prej 29,153 familjesh, duke reflektuar një nivel realizimi prej rreth 93%. Ky tregues evidenton vijimësinë e mbështetjes së familjeve përfituese nga skemat ekzistuese të strehimit, megjithëse për disa produkte zbatimi pritet të reflektohet në periudhat pasuese të vitit.

Në kuadër të kategorive prioritare, treguesi për përfituesit e kategorisë “femra të dhunuara” dhe “gra kryefamiljare” paraqitet në nivel të lartë realizimi, me 1,992 përfitues kundrejt planit prej 2,000 përfituesish, ose rreth 100%. Kjo tregon se programi vijon të ruajë fokusin në mbështetjen e kategorive sociale më të ndjeshme.

Për komunitetin Rom dhe Egjiptian, treguesi i përfituesve paraqitet pa realizim për periudhën raportuese, kundrejt planit vjetor prej 3,600 përfituesish. Gjithashtu, treguesit që lidhen me përqindjen e përfituesve Rom dhe Egjiptian në skemën e kredive të reja dhe në projektet për përmirësimin e banesave ekzistuese/rikonstrukcionin e godinave nuk paraqesin realizim në 4-mujorin e parë. Kjo lidhet me faktin se këto ndërhyrje kërkojnë procedura paraprake, bashkërendim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe plotësim të dokumentacionit përkatës përpara se të reflektohen në treguesit fizikë dhe financiarë.

Në kuadër të produkteve korente, gjatë periudhës raportuese realizimi është përqendruar kryesisht te skema e kredive ekzistuese që subvencionohen, ku janë mbështetur 5,800 përfitues, duke realizuar plotësisht treguesin e planifikuar për këtë produkt. Për produktin “Kredi të reja” janë evidentuar 146 përfitues, kundrejt planit vjetor prej 800 përfituesish, duke reflektuar një nivel më të kufizuar realizimi në këtë fazë të vitit. Produktet “Bonusi i qirasë”, “Subvencionimi i qirasë për banorët e shpronësuar sipas VKM-së nr. 409, datë 15.06.2022” dhe “Grant i menjëhershëm” nuk paraqesin realizim fizik gjatë periudhës raportuese.

Në komponentin e investimeve, programi parashikon ndërhyrje për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian, përmirësimin e infrastrukturës në zona informale që janë në proces legalizimi, përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara, si dhe adaptimin e godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social. Për periudhën raportuese, këto produkte nuk paraqesin realizim fizik dhe financiar të reflektuar në anekset e monitorimit.

Megjithatë, sipas raportimit mbi ecurinë e investimeve, një pjesë e fondeve të programit janë rialokuar tek bashkitë për vijimin dhe mbylljen e projekteve të nisura gjatë vitit 2025. Për këtë arsye, mungesa e realizimit në 4-mujorin e parë nuk duhet interpretuar si mungesë aktiviteti, por si rezultat i kohës së nevojshme për pasqyrimin e likuidimeve, raportimin nga njësitë vendore, paraqitjen e dokumentacionit justifikues dhe situacioneve përkatëse.

Në përfundim, performanca jo-financiare e programit për 4-mujorin 2026 paraqitet e qëndrueshme për disa tregues kyç, veçanërisht për vijimësinë e mbështetjes së familjeve përfituese dhe kategorive prioritare. Megjithatë, realizimi mbetet i kufizuar për produktet që lidhen me investimet dhe disa skema të strehimit social, të cilat pritet të reflektohen në periudhat pasuese, pas përfundimit të procedurave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe pasqyrimin të fondeve të transferuara në realizim konkret fizik dhe financiar.

Në aspektin jo-financiar, Programi 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional” ka vijuar gjatë periudhës raportuese me zbatimin e objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, në drejtim të ofrimit të arsimit dhe formimit profesional cilësor, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave të tregut të punës.

Gjatë vitit shkollor 2025–2026, arsimi profesional publik është ofruar në 31 shkolla publike të arsimit profesional, me 92 kualifikime të niveleve II–V të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Numri total i nxënësve që kanë ndjekur arsimin profesional publik është 16,080 nxënës, nga të cilët 2,798 janë vajza. Këto të dhëna tregojnë vijimësinë e interesit për arsimin profesional dhe rolin e këtij programi në rritjen e aksesit të rinjve në formim profesional.

Në kuadër të objektivit për rritjen e aksesit dhe gjithëpërfshirjes, programi ka mbështetur pjesëmarrjen e nxënësve nga grupet në nevojë dhe kategoritë e veçanta. Gjatë vitit shkollor 2025–2026, arsimin profesional e kanë ndjekur 221 nxënës me nevoja të veçanta, 611 nxënës nga komunitetet rom dhe egjiptian, ndërsa rreth 50% e nxënësve vijnë nga zonat rurale. Gjithashtu, skema e bursave ka mbështetur rreth 776 nxënës, duke kontribuar në nxitjen e pjesëmarrjes së vajzave, nxënësve në vështirësi ekonomike, nxënësve me nevoja të veçanta, komuniteteve rom dhe egjiptiane, si dhe nxënësve në degë prioritare për zhvillimin ekonomik. Në funksion të rritjes së relevancës së arsimit profesional me tregun e punës, është vijuar me zgjerimin dhe diversifikimin e ofertës së kualifikimeve profesionale. Një komponent i rëndësishëm është zhvillimi i programeve të arsimit pas të mesëm në nivelin V të KSHK-së, ku janë regjistruar 314 nxënës, nga të cilët 157 janë femra. Këto programe synojnë forcimin e aftësive profesionale të specializuara dhe përmirësimin e mundësive të punësimit të përfituesve.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese është mbështetur zbatimi i programeve të formimit dual në arsimin profesional publik, të cilat janë ndjekur nga 350 nxënës. Ky model ka rëndësi të veçantë për forcimin e lidhjes ndërmjet arsimit profesional dhe sektorit privat, pasi kombinon procesin mësimor me përvojën praktike në biznes dhe kontribuon në përgatitjen e nxënësve me aftësi më të përshtatura me kërkesat reale të ekonomisë.

Në drejtim të sigurimit të cilësisë në arsimin dhe formimin profesional, gjatë 4-mujorit janë ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e kuadrit rregullator, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kualifikimeve profesionale, trajnimin e mësimdhënësve, vetëvlerësimin institucional, akreditimin dhe inspektimin e ofruesve të AFP-së. Gjatë kësaj periudhe janë hartuar 20 standarde profesionale dhe kualifikimesh, duke u mbështetur në analizën e kualifikimeve ekzistuese, rekomandimet e Komiteteve Sektoriale dhe nevojat e tregut të punës, veçanërisht në fusha si teknologjia e informacionit, mikpritja dhe turizmi, energjia dhe bujqësia.

Në të njëjtën linjë, janë hartuar 27 skeletkurrikula dhe materiale mësimore, duke përfshirë skeletkurrikula të reja për nivelet IV dhe V të KSHK-së, si dhe për arsimin e dyfishtë. Ky proces ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e përmbajtjes mësimore, rritjen e cilësisë së procesit të të nxënësve dhe përafrimin e programeve me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet sektoriale.

Forcimi i kapaciteteve të stafit mësimor ka qenë një tjetër komponent i rëndësishëm i performancës jo-financiare. Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2026, 140 mësues janë përfshirë në procesin e trajnimit fillestar dhe të vazhduar. Nga këta, 75 mësues janë në proces trajnimi në kuadër të zhvillimit profesional të vazhduar, ndërsa 65 mësimdhënës ndjekin programin 30-ditor “Bazat e Didaktikës në AFP”. Këto ndërhyrje kontribuojnë në përmirësimin e kompetencave pedagogjike dhe metodologjike të mësimdhënësve, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies në arsimin profesional.

Në kuadër të përmirësimit të mekanizmave të cilësisë, janë mbështetur 41 ofrues të AFP-së në procesin e vetëvlerësimit, ndërsa 6 ofrues të tjerë janë në proces miratimi për akreditim. Po ashtu, janë kryer 5 inspekte pranë ofruesve të arsimit dhe formimit profesional, të cilat kanë pasur si qëllim verifikimin e përputhshmërisë me standardet e përcaktuara dhe kuadrin rregullator në fuqi. Këto procese kontribuojnë në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe cilësisë së ofruesve të AFP-së.

Nga pikëpamja institucionale dhe rregullatore, gjatë periudhës raportuese janë hartuar dhe miratuar 6 akte nënligjore, si dhe janë përgatitur raporte monitorimi të politikave të AFP-së dhe raporte në kuadër të Programit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe procesit të integritetit evropian. Këto ndërhyrje mbështesin konsolidimin e reformës në arsimin dhe formimin profesional dhe përafrimin e sistemit me standardet dhe kërkesat evropiane.

Në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, investimet në shkolla, reparte praktikash profesionale, makineri, pajisje laboratorike, kompjutera dhe pajisje digjitale synojnë rritjen e cilësisë së mësimi praktik dhe përmirësimin e kushteve të ofrimit të arsimit profesional. Edhe pse realizimi financiar i investimeve për 4-mujorin paraqitet në nivel të ulët, projektet janë të lidhura me përmirësimin afatgjatë të kapaciteteve fizike dhe teknike të institucioneve të AFP-së dhe pritet të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e procesit mësimor dhe praktik.

Në tërësi, performanca jo-financiare e Programit 09240 vlerësohet pozitive, pasi gjatë periudhës raportuese janë evidentuar rezultate konkrete në rritjen e aksesit, gjithëpërfshirjen e grupeve në nevojë, zgjerimin e ofertës së kualifikimeve, zhvillimin e arsimit dual, përmirësimin e standardeve dhe kurrikulave, trajnimin e mësimitdhënësve, mbështetjen e ofruesve të AFP-së për sigurimin e cilësisë, si dhe forcimin e kuadrit institucional dhe rregullator. Këto zhvillime krijojnë premisa për rritjen e cilësisë së arsimit profesional, forcimin e lidhjes me tregun e punës dhe përmirësimin e punësueshmërisë së të rinjve.

Program - Mbështetje për Zhvillim Ekonomik

Në aspektin jo-financiar, Programi 04130 “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik” ka vijuar të mbështesë funksionet kryesore të institucioneve të përfshira në këtë program, që lidhen me përmirësimin e klimës së biznesit, ofrimin e shërbimeve ndaj biznesit, promovimin e investimeve, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, administrimin e proceseve që lidhen me koncesionet/PPP, si dhe hartimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e zhvillimit ekonomik.

Performanca jo-financiare e programit paraqitet e diferencuar sipas produkteve dhe institucioneve zbatuese. Produktet që lidhen me funksionimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit kanë pasur ecuri më të mirë në krahasim me disa produkte të tjera, pasi lidhen me shërbime të vazhdueshme që ofrohen për bizneset. Për produktin “Shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të regjistrimit të licencave”, janë realizuar 4,472 shërbime kundrejt 7,700 të planifikuara, duke arritur rreth 58% të treguesit vjetor. Ky nivel performante tregon vijimësi të shërbimeve ndaj biznesit në fushën e licencimit dhe mbështet funksionimin normal të sistemit të licencave.

Për produktin “Shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të regjistrimit të biznesit”, janë realizuar 47,225 shërbime kundrejt 273,000 të planifikuara në vit. Duke qenë se ky produkt ka natyrë të vazhdueshme dhe varet nga kërkesat e subjekteve për regjistrim, ndryshim të dhënash, pezullim, çregjistrim apo shërbime të tjera pranë QKB-së, realizimi për periudhën raportuese duhet të lexohet në raport me shpërndarjen vjetore të kërkesave dhe jo si mospërmbyllje përfundimtare e objektivit. Megjithatë, vijimi i këtij produkti mbetet thelbësor për lehtësimin e procedurave administrative për biznesin dhe përmirësimin e klimës së të bërit biznes.

Në drejtim të promovimit të investimeve dhe mbështetjes së ndërkombëtarizimit të sipërmarrjeve shqiptare, produkti “Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh / kujdesi ndaj investorëve” ka realizuar 16 aktivitete/shërbime kundrejt 50 të planifikuara, ose rreth 32% të treguesit vjetor. Gjatë periudhës Janar–Prill 2026, AIDA ka marrë pjesë dhe ka mbështetur prezencën e kompanive shqiptare në disa panaire dhe aktivitete ndërkombëtare, përfshirë Biofach 2026 në Nuremberg, Food Expo / EXPOFOOD Athens 2026 në Athinë, ITB Berlin 2026 në Berlin, MIPIM 2026 në Kanë, Global Real Estate Summit 2026 në Londër, si dhe MACFRUT 2026 në Rimini. Këto aktivitete kanë shërbyer për promovimin e produkteve shqiptare, nxitjen e eksporteve, krijimin e kontakteve me kompani të huaja dhe prezantimin e Shqipërisë si destinacion për investime në sektorë me potencial zhvillimi, si turizmi, real estate, agro-ushqimi, produktet organike dhe teknologjitë agro-industriale.

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në vend, AIDA ka organizuar dhe mbështetur evente me fokus investimet, eksportin dhe dialogun publik–privat, si MatchMaker Albania 2026, EksportON 2026, si dhe aktivitete të lidhura me rrjetin Enterprise Europe Network, përfshirë MatchMaker Albania 2, Agriculture Day Expo në Lushnje dhe përgatitjet për eventin MUSE-X në bashkëpunim me EEN Puglia. Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese janë realizuar 32 takime aftercare me investorë vendas dhe të huaj, duke kontribuar në adresimin e problematikave të investorëve ekzistues dhe forcimin e klimës së investimeve në vend.

Në funksion të nxitjes dhe tërheqjes së investimeve të huaja direkte, AIDA ka marrë pjesë në një sërë forumesh biznesi dhe aktiviteteve ekonomike ndërkombëtare, ndër të cilat Forumi i Biznesit Shqipëri–Slloveni, Forumi i Biznesit Japoni–Shqipëri, Forumi Ekonomik Shqipëri–Kosovë, Forumi i Biznesit Shqipëri–Japoni në Tiranë, Samiti IV i Diasporës, Kosova Finance Forum dhe Konferenca e Biznesit Gjermani–Shqipëri. Këto aktivitete kanë kontribuar në zgjerimin e rrjeteve të bashkëpunimit ekonomik, promovimin e mundësive investuese të Shqipërisë dhe krijimin e kontakteve me partnerë institucionalë dhe biznesorë ndërkombëtarë.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese AIDA ka nënshkruar 6 memorandume bashkëpunimi me agjenci homologe dhe partnerë ndërkombëtarë, përfshirë SPIRIT Slovenia Business Development Agency, Lidhjen e Bizneseve të Kosovës, Bulgarian-Albanian Business Chamber, 28Digital, Odën Ekonomike të Kosovës dhe EUBACCI. Këto memorandume synojnë forcimin e bashkëpunimit institucional, promovimin e investimeve, mbështetjen e SME-ve, nxitjen e inovacionit dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Në fushën e investimeve strategjike, AIDA ka vijuar funksionet si One Stop Shop për aplikimet për investim/investitor strategjik, Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) dhe agjent asistues i investitorit strategjik. Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2026, janë evidentuar 7 projekte në fazë asistimi, 2 projekte në proces vlerësimi dhe 3 projekte të miratuara me vendim të KIS, nga të cilat një projekt ka marrë miratim statusi për herë të parë dhe dy projekte lidhen me shtyrjen e afatit të statusit strategjik. Gjithashtu, në kuadër të monitorimit të zbatimit të vendimeve të KIS, u janë dërguar shkresa monitorimi 11 subjekteve, me qëllim ndjekjen e ecurisë së projekteve dhe përgatitjen e raporteve përkatëse të monitorimit.

Për produktin “Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, treguesi i planifikuar është 40 përfitues/projekte, ndërkohë që për periudhën raportuese nuk rezulton ende realizim. Kjo lidhet me faktin se skemat e granteve kanë natyrë procedurale dhe kërkojnë hapjen e thirrjes, pranimin e aplikimeve, vlerësimin teknik dhe financiar, përzgjedhjen e

përfituesve dhe miratimin përfundimtar. Thirrja për “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është publikuar nga AIDA në faqen zyrtare më datë 11.05.2026 dhe do të qëndrojë e hapur për 30 ditë kalendarike. Shpallja e ndërmarrjeve fituese dhe procesi i disbursimit të fondit parashikohet të kryhen brenda vitit 2026. Për këtë arsye, mungesa e realizimit në 4-mujor nuk nënkupton mungesë nevojë apo mungesë performance të programit, por reflekton fazën procedurale në të cilën ndodhet zbatimi i skemës.

Në fushën e koncesioneve dhe partneritetit publik-privat, produkti “Studime fizibiliteti për projektet koncesionare/PPP” ka realizuar 5 studime/procese kundrejt 20 të planifikuara, ose rreth 25% të treguesit vjetor. Ky nivel performance reflekton vijimin e punës teknike të ATRAKO-s në mbështetje të analizimit dhe trajtimit të projekteve koncesionare/PPP. Ndërkohë, produkti “Kontrata koncesione/PPP të publikuara në regjistrin elektronik të koncesioneve” nuk paraqet ende realizim për periudhën raportuese, pasi publikimi në regjistrë varet nga ecuria e proceseve dhe dokumentacionit përkatës për kontratat që administrohen në këtë fushë.

Për produktin “Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara”, është realizuar 1 akt/proces kundrejt 17 të planifikuara në planin e rishikuar. Ky nivel realizimi është i lidhur me natyrën e procesit rregullator, i cili kërkon konsultim ndërinstytucional, hartim teknik, koordinim me institucionet përgjegjëse, reflektim komentesh dhe ndjekje të procedurave të miratimit. Për këtë arsye, realizimi i ulët në periudhën e parë të vitit nuk përjashton përshpejtimin e treguesit në periudhat pasuese, në varësi të kalendarit të miratimit të akteve.

Në drejtim të investimeve, performanca jo-financiare është e lidhur me forcimin e kapaciteteve teknike, logjistike dhe digjitale të institucioneve zbatuese të programit. Projekti “Blerje pajisje kompjuterike” ka realizuar 18 njësi kundrejt 38 të planifikuara, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve teknike të punës dhe mbështetjen e funksioneve institucionale.

Në kuadër të projektit me financim të huaj “EEN Albania”, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar aktivitete që mbështesin ndërkombëtarizimin e SME-ve shqiptare, rrjetëzimin me partnerë të huaj dhe promovimin e produkteve shqiptare në tregjet evropiane. Ndër aktivitetet kryesore përmenden EXPOFOOD Athens 2026, BIOFACH 2026, MACFRUT 2026, MatchMaker Albania 2, Agriculture Day Expo në Lushnje, si dhe organizimi në proces i eventit MUSE-X në bashkëpunim me EEN Puglia. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve janë mbështetur kompani shqiptare në promovimin ndërkombëtar, organizimin e takimeve B2B, identifikimin e partnerëve potencialë dhe krijimin e mundësive për bashkëpunime tregtare dhe partneritete ndërkombëtare.

Për disa projekte të tjera investimi, si “Blerje pajisje zyre”, “Pajisje audiovizuale”, “Pajisje teknologjike/elektronike”, “Projekt preventiv rikonstruksion zyrash” dhe “Rikonstruksion i pjesshëm zyrash”, nuk rezulton ende realizim i treguesve sasiore për periudhën raportuese. Kjo lidhet kryesisht me faktin se projektet ndodhen në fazë përgatitore apo procedurale, përfshirë identifikimin e nevojave, hartimin e specifikimeve teknike, kërkesat drejtuar institucioneve përgjegjëse për prokurimin dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës.

Në tërësi, performanca jo-financiare e Programit 04130 vlerësohet me ecuri të pjesshme dhe të diferencuar sipas produkteve. Produktet që lidhen me shërbimet e vazhdueshme ndaj biznesit, promovimin e investimeve, kujdesin ndaj investitorëve, ndërkombëtarizimin e SME-ve dhe funksionimin institucional kanë pasur realizim më të dukshëm. Ndërkohë, produktet që lidhen me skemat e granteve, aktet rregullatore, disa procese PPP dhe investimet kapitale paraqesin

realizim më të ulët për shkak të natyrës procedurale dhe kalendarit të zbatimit. Programi vijon të ketë rëndësi për përmirësimin e klimës së biznesit, mbështetjen e sipërmarrjes, promovimin e investimeve, nxitjen e eksporteve, ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve shqiptare dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në funksion të zhvillimit ekonomik.

Programi - Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale”

Në aspektin jo-financiar, Programi 04160 ka vijuar të mbështesë funksionet kryesore të infrastrukturës së cilësisë, mbikëqyrjes së tregut dhe pronësisë industriale, me qëllim zbatimin e kërkesave ligjore, garantimin e sigurisë së produkteve jo-ushqimore në treg, verifikimin e instrumenteve matëse, njohjen ndërkombëtare të certifikatave të akreditimit dhe adoptimin e standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ka vijuar funksionin e saj si organizmi kombëtar i akreditimit për organet e vlerësimit të konformitetit. Gjatë periudhës raportuese janë pranuar 15 aplikime nga organizma të vlerësimit të konformitetit, janë shqyrtuar 9 aplikime, janë marrë 39 vendime sipas fushave të akreditimit dhe janë trajtuar 27 dosje. Numri i organizmave të akredituar deri më 30.04.2026 është 9, nga të cilët 3 laboratorë testues, 1 trupë inspektuese, 2 organizma certifikimi personi dhe 3 organizma certifikimi sistemesh. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, numri i trupave të akredituara është rritur me 2 organizma, duke treguar ecuri pozitive në forcimin e sistemit të akreditimit.

Në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve, DPA ka realizuar trajnime për palë të treta dhe trajnime të brendshme. Janë trajnuar 26 persona për standardin ISO/IEC 17025, si dhe 16 persona për kërkesat e ISO/IEC 17011 dhe procedurat e menaxhimit të riskut. Këto aktivitete kontribuojnë në rritjen e cilësisë së shërbimeve të akreditimit dhe në forcimin e besueshmërisë së rezultateve të vlerësimit të konformitetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ka vijuar me adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si Standarde Shqiptare. Gjatë periudhës Janar–Prill 2026 janë adoptuar 158 standarde dhe dokumente standardizimi, nga të cilat 114 standarde me origjinë evropiane CEN, 40 standarde ISO dhe 4 standarde IEC. Fushat me numër më të lartë adoptimesh lidhen me analizat e produkteve ushqimore, vajrat dhe yndyrnat ushqimore, sigurinë e makinerisë, atmosferat shpërthyes, cilësinë e ujit, ajrit dhe tokës, si dhe pajisjet elektrike dhe elektronike. Gjithashtu, për periudhën Janar–Prill 2026 janë shitur 298 standarde, duke gjeneruar të ardhura në vlerën 662,880 lekë. Standardet më të shitura lidhen me fushat e analizave të produkteve ushqimore, materialeve në kontakt me ushqimin, cilësinë e ujit, ajrit dhe tokës, betonin dhe produktet e lidhura me të, sigurinë e makinerisë, sigurinë ndaj zjarrit, dokumentacionin dhe informacionin, si dhe pajisjet e përdorimit të gazit të lëngët nga nafta. Kjo tregon vijimin e rolit të DPS-së në mbështetje të biznesit, institucioneve dhe palëve të interesuara me standarde teknike bashkëkohore.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka vijuar veprimtarinë në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve, zhvillimit të sistemit kombëtar të metrologjisë dhe njohjes ndërkombëtare të rezultateve të matjeve dhe etaloneve kombëtare. Për periudhën raportuese janë realizuar gjithsej 12,234 verifikime dhe kalibrime, kundrejt 41,300 të planifikuara për vitin, duke përfaqësuar rreth 30% të planit të miratuar.

Në të njëjtën kohë, DPM ka nisur procesin e akreditimit të katër laboratorëve kalibrues: laboratorit të gjatësisë, laboratorit të elektricitetit, laboratorit të temperaturës dhe laboratorit të radarëve të shpejtësisë. Procesi i vlerësimit nga trupa vlerësuese e institucionit të akreditimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka përfunduar dhe pritet raporti final. Gjithashtu, ka

nisur procesi i vlerësimit për akreditimin e laboratorit të masës në sektorët e shërbimit të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Këto procese janë të rëndësishme për forcimin e kapaciteteve teknike dhe për njohjen e shërbimeve metrologjike sipas standardeve ndërkombëtare.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka vijuar aktivitetin në funksion të garantimit të sigurisë së produkteve për konsumatorët dhe respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale. Gjatë periudhës Janar–Prill 2026 janë kryer gjithsej 948 inspektime, kundrejt 2,346 inspektimeve të planifikuara për vitin 2026. Fokusi i inspektimeve ka qenë tek ashensorët, lodrat, detergjentët, instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara në përdorim, parapaketime, produktet elektrike dhe produktet e shportës.

Në kuadër të veprimtarisë inspektuese, nga Sektori Kimik dhe Siguria e Përgjithshme janë bllokuar 632 produkte të rrezikshme, bazuar në njoftimin e ardhur nga sistemi RASFF. Gjithashtu, janë vendosur 24 masa urgjente për ndalimin e tregtimit të mallrave të falsifikuara ose të dyshuara si të falsifikuara, duke përfshirë detergjentë, shampo, veshje, aksesore, pajisje elektrike dhe produkte të tjera që cenojnë marka tregtare. Këto masa kontribuojnë në mbrojtjen e konsumatorëve, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

ISHMT ka zhvilluar gjithashtu aktivitete ndërgjegjësuëse dhe informuese për respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe rolin e institucionit. Ndër aktivitetet kryesore përmenden vizita edukative me studentë, tryeza informuese me bizneset, leksione të hapura me rastin e Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, si dhe tryeza shumëpalëshe me bizneset dhe institucionet e zbatimit të ligjit. Gjithashtu, është firmosur marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet ISHMT-së dhe Drejtorisë për të Drejtat e Autorit, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të autorit.

Në aspektin e kapaciteteve njerëzore dhe trajnimeve, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar trajnime për stafin e ISHMT-së, përfshirë trajnimin mbi inteligjencën artificiale për shërbimin publik dhe trajnimin për vlerësimin e riskut të integritetit dhe hartimin e planit të integritetit në institucionet publike. Në veprimtarinë inspektuese kanë marrë pjesë 36 inspektorë meshkuj dhe 16 inspektore femra, duke reflektuar përfshirjen e trupës inspektuese në terren.

Në tërësi, performanca jo-financiare e Programit 04160 vlerësohet pozitive dhe e lidhur ngushtë me funksionet bazë të institucioneve të infrastrukturës së cilësisë dhe mbikëqyrjes së tregut. Gjatë periudhës raportuese janë evidentuar rezultate konkrete në akreditim, standardizim, metrologji, mbikëqyrje tregu, mbrojtje të konsumatorit dhe respektim të të drejtave të pronësisë intelektuale. Programi ka kontribuar në forcimin e sigurisë së produkteve, rritjen e cilësisë së shërbimeve teknike, përafrimin me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe në mbrojtjen më efektive të konsumatorëve dhe operatorëve ekonomikë në treg.

Programi - Inspektimi në Punë

Në aspektin jo-financiar, Programi 4170 “Inspektimi në Punë” ka shënuar një ecuri pozitive gjatë vitit 2026, duke reflektuar jo vetëm realizim të mirë të treguesve sasiore, por edhe forcim të kapaciteteve institucionale dhe përmirësim të cilësisë së veprimtarisë inspektuese. Realizimi i **8,674 inspektimeve** kundrejt **9,000 inspektimeve** të planifikuara tregon një nivel të lartë përmbushjeje të objektivave operative, me një realizim prej rreth **96%** të treguesit të planifikuar. Ky nivel performance dëshmon vijimësinë e aktivitetit inspektues në terren dhe mbulimin e gjerë të subjekteve në funksion të zbatimit të legjislacionit të punës.

Krahas numrit të inspektimeve, rëndësi të veçantë ka pasur edhe cilësia e procesit inspektues, e cila lidhet me identifikimin e shkeljeve, orientimin e subjekteve drejt përmbushjes së detyrimeve ligjore, rritjen e ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve, si dhe forcimin e kulturës së sigurisë dhe shëndetit në punë. Në këtë kuadër, veprimtaria e ISHPSHSH-së ka kontribuar në përmirësimin e mbikëqyrjes së marrëdhënieve të punës, formalizimin e detyrimeve të punëdhënësve dhe mbrojtjen më efektive të të drejtave të punëmarrësve.

Realizimi i investimeve në automjete, pajisje elektronike dhe pajisje të tjera mbështetëse ka ndikuar drejtpërdrejt në performancën jo-financiare të programit, pasi ka përmirësuar mobilitetin e inspektorëve, aksesin në subjektet që ushtrojnë aktivitet në territor, si dhe kushtet teknike për kryerjen e inspektimeve. Blerja e automjeteve ka forcuar kapacitetet logjistike të institucionit dhe ka krijuar mundësi për reagim më të shpejtë dhe mbulim më të mirë territorial, veçanërisht në zona ku prania inspektuese kërkon lëvizshmëri më të lartë.

Gjithashtu, pajisjet elektronike dhe infrastruktura mbështetëse kanë ndihmuar në rritjen e eficiencës administrative, përpunimin më të mirë të informacionit, dokumentimin e veprimtarisë inspektuese dhe përmirësimin e komunikimit institucional. Këto elemente përbëjnë bazë të rëndësishme për modernizimin gradual të procesit të inspektimit dhe për orientimin drejt një qasjeje më efektive, më të shpejtë dhe më të mirë-dokumentuar në kontrollin e zbatimit të ligjit.

Në tërësi, performanca jo-financiare e programit vlerësohet pozitive, pasi treguesit e realizuar dëshmojnë për vijimësi të aktivitetit inspektues, përmirësim të kapaciteteve logjistike dhe teknike, si dhe kontribut të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe forcimin e rolit mbikëqyrës të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Programi - Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji

Realizimi jo financiar i programit 01150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji” për periudhën janar–prill 2026 paraqitet i pjesshëm dhe lidhet kryesisht me ecurinë e aktiviteteve në funksion të zhvillimit të politikave të inovacionit dhe teknologjisë, forcimit të kapaciteteve institucionale, mbështetjes së ekosistemit të startup-eve, si dhe zbatimit të proceseve dhe shërbimeve inovative.

Staf i trajnuar – Për këtë produkt është planifikuar realizimi i 10 trajnimeve/aktivitetesh, ndërkohë që gjatë periudhës raportuese nuk rezulton realizim sasior i evidentuar. Aktivitetet e lidhura me këtë produkt janë në funksion të forcimit të kapaciteteve të stafit dhe zhvillimit institucional në fushën e inovacionit dhe teknologjisë, por realizimi pritet të reflektohet në periudhat pasuese.

Shërbime dhe procese inovative të zbatuara – Për këtë produkt janë planifikuar 13 njësi, nga të cilat janë realizuar 2 njësi, ose 15.4% e planit fizik. Gjatë periudhës raportuese, Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës, si pjesë e strukturës së re Innovation4Albania, ka vijuar ushtrimin e funksioneve në mbështetje të zhvillimit të proceseve dhe shërbimeve inovative, forcimit të kapaciteteve institucionale dhe implementimit të iniciativave në fushën e inovacionit.

Akte ligjore/nënligjore të miratuara – Për këtë produkt janë planifikuar 10 akte, ndërkohë që gjatë periudhës raportuese nuk rezulton realizim sasior i evidentuar. Produkti lidhet me hartimin, bashkërendimin dhe monitorimin e politikave shtetërore në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe standardeve të shërbimeve publike.

Takime për përmirësimin e klimës së biznesit – Për këtë produkt janë planifikuar 70 takime, nga të cilat janë realizuar 40 takime, ose 57.1% e planit fizik. Ky produkt lidhet me forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe aktorëve të ekosistemit të

inovacionit dhe startup-eve, në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit dhe nxitjes së sipërmarrjes inovative.

Kompani Start Up të mbështetura – Për këtë produkt janë planifikuar 85 kompani, ndërkohë që gjatë periudhës raportuese nuk rezulton realizim fizik. Kjo lidhet me faktin se aplikimet për thirrjen e granteve 2026 janë ende në proces vlerësimi dhe disbursimi për subjektet fituese do të kryhet në vijim, pas përfundimit të procedurave përkatëse.

Pajisje zyre AIE – Për këtë projekt janë planifikuar 98 njësi, ndërkohë që gjatë periudhës raportuese nuk rezulton realizim fizik. Projekti lidhet me pajisjen dhe mbështetjen funksionale të Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës, por realizimi pritet të vijojë pas përfundimit të procedurave përkatëse dhe kalimit të fondeve në kuadër të riorganizimit institucional.

Pajisje kompjuterike AIE – Për këtë projekt janë planifikuar 14 njësi, ndërkohë që gjatë periudhës raportuese nuk rezulton realizim fizik. Mosrealizimi lidhet me fazën procedurale të investimit dhe me procesin e kalimit të fondeve drejt strukturës së re përgjegjëse, në vijim të riorganizimit institucional.

Fond i ngrirë – Për këtë projekt është planifikuar 1 procedurë/projekt, ndërkohë që realizimi fizik rezulton ende i pafundimtar. Megjithatë, janë hartuar specifikimet teknike, është përllogaritur fondi limit, praktika është përcjellë pranë OBP-së dhe është likuiduar tarifa e OBP-së. Për rrjedhojë, projekti është në fazë procedurale dhe realizimi fizik/financiar pritet të reflektohet në periudhat pasuese.

Në përmbledhje, realizimi jo financiar i programit paraqitet i pjesshëm. Produktet me ecuri më të dukshme janë “Takime për përmirësimin e klimës së biznesit”, me realizim 57.1%, dhe “Shërbime dhe procese inovative të zbatuara”, me realizim 15.4%. Produktet që lidhen me trajnimet, aktet ligjore/nënligjore, mbështetjen e startup-eve dhe investimet në pajisje nuk kanë ende realizim të plotë të reflektuar në treguesit fizikë. Devijimet lidhen kryesisht me fazat e vlerësimit, miratimit dhe disbursimit të granteve, procedurat e prokurimit, si dhe procesin e riorganizimit institucional të agjencive në kuadër të krijimit të Innovation4Albania.

Programi - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

Gjatë periudhës së raportimit, Programi 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” ka mbështetur funksionimin e strukturave qendrore të ministrisë, përmes realizimit të produkteve që lidhen me koordinimin institucional, menaxhimin administrativ, përgatitjen dhe ndjekjen e akteve ligjore e nënligjore, si dhe përmirësimin e kushteve teknike dhe logjistike të punës.

Në aspektin e performancës jo financiare, produkti “Numër raportesh/aktesh ligjore dhe nënligjore të koordinuara” paraqet realizim të plotë në raport me planifikimin sasior. Për vitin 2026 janë planifikuar 18 raporte/akte, të cilat rezultojnë të realizuara në të njëjtin nivel, duke reflektuar vijueshmëri në ushtrimin e funksioneve koordinuese, përgatitore dhe mbështetëse të ministrisë në proceset vendimmarrëse, rregullatore dhe administrative.

Gjithashtu, produkti “Staf i rekrutuar/trajnuar” rezulton i realizuar në nivelin e planifikuar, me 30 punonjës të rekrutuar/trajnuar, duke treguar angazhimin për forcimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të strukturave të ministrisë. Ky tregues lidhet drejtpërdrejt me nevojën për rritjen e efektivitetit institucional, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve mbështetëse dhe garantimin e vijueshmërisë së funksioneve pas proceseve të riorganizimit institucional.

Në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse, janë parashikuar produkte që lidhen me rikonstruksionin e godinës për ish-ambientet e MZHETS, blerjen e pajisjeve TIK për ministrinë, si dhe blerjen e automjeteve për ministrinë. Këto ndërhyrje synojnë krijimin e kushteve më të përshtatshme të punës, rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe përmirësimin e mbështetjes logjistike për strukturat e ministrisë. Për disa prej këtyre produkteve, megjithëse planifikimi fizik është kryer, realizimi financiar paraqitet ende i kufizuar ose nuk ka nisur, çka tregon se proceset përkatëse janë në fazë përgatitore/procedurale dhe kërkojnë ndjekje të mëtejshme për përfundimin e tyre brenda vitit buxhetor.

Në tërësi, performanca jo financiare e programit vlerësohet pozitive për produktet që lidhen me funksionet bazë institucionale, veçanërisht sa i përket koordinimit të akteve dhe forcimit të kapaciteteve njerëzore. Ndërkohë, produktet me natyrë investuese dhe logjistike do të monitorohen nga struktura përgjegjëse, me qëllim përshejtimin e procedurave dhe sigurimin e realizimit të objektivave fizike të planifikuara.

Te ardhurat jashtë limit kapitull 06

Gjatë periudhës janar–prill 2026, përveç fondeve buxhetore të miratuara në planin e ministrisë, janë realizuar edhe shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit, në shumën totale 18,684,679 lekë. Këto shpenzime janë evidentuar kryesisht në programet 04160 “Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale”, 10550 “Tregu i Punës” dhe 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional”. Pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve e zë programi 10550 “Tregu i Punës”, me 16,152,560 lekë, të përdorura kryesisht nga AKPA dhe Qendrat e Formimit Profesional për shpenzime korente dhe kapitale, përfshirë materiale shërbimi, pajisje, mjete transporti dhe nevoja të tjera në funksion të ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional. Programi 04160 paraqet shpenzime në shumën 1,695,635 lekë, kryesisht për mallra dhe shërbime dhe certifikata akreditimi/metrologjie të njohura në vend. Ndërsa programi 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional” paraqet shpenzime në shumën 836,484 lekë, të përdorura nga shkollat profesionale për pajisje, mallra dhe shërbime.

Tabela 1. Përmbledhje sipas programeve

Programi	Emërtimi i programit	Shuma në lekë
04160	Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, Infrastrukturën e Cilësisë dhe Pronësinë Industriale	1,695,635
10550	Tregu i Punës	16,152,560
09240	Arsimi i Mesëm Profesional	836,484
TOTAL		18,684,679

Tabela 2. Programi 10550 “Tregu i Punës”

Nr.	Institucioni / njësia zbatuese	Artikulli	Përshkrimi	Shuma në lekë
1	Qendra e Formimit Profesional nr. 1, Tiranë	231	Orendi, pajisje të ndryshme, Kap. 6	219,760
2	Qendra e Formimit Profesional nr. 1, Tiranë	600	Të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional	28,060

3	Qendra e Formimit Profesional nr. 1, Tiranë	602	Të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional	1,891,800
4	Qendra e Formimit Profesional Fier	231	Orendi, pajisje të ndryshme, Kap. 6	358,080
5	Qendra e Formimit Profesional Fier	231	Të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional	112,800
6	Qendra e Formimit Profesional Lezhë	231	Të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional	118,860
7	Drejtoria Qendrore AKPA	231	Mjete transporti	4,740,000
8	Drejtoria Qendrore AKPA	602	Leje pune për shtetasit e huaj, raportime statistikore/financiare, procedura	8,683,200
	Totali i programit 10550			16,152,560

Tabela 3. Programi 04160

Nr.	Institucioni / njësia zbatuese	Artikulli	Përshkrimi	Shuma në lekë
1	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	602	Mallra dhe shërbime, Kap. 6	1,042,041
2	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	602	Certifikata akreditimi të njohura në vend	554,894
3	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	605	Certifikata akreditimi të njohura në vend	98,700
	Totali i programit 04160			1,695,635

Tabela 4. Programi 09240

Nr.	Institucioni / njësia zbatuese	Artikulli	Përshkrimi	Shuma në lekë
1	Shkolla Profesionale “Mihal Shahini”, Elbasan	231	Orendi, pajisje të ndryshme, Kap. 6	98,400
2	Shkolla Profesionale “Mihal Shahini”, Elbasan	602	Nxënës që ndjekin shkollat e arsimit profesional	325,194
3	Shkolla e Shërbimeve, Korçë	231	Orendi, pajisje të ndryshme, Kap. 6	216,000
4	Shkolla e Shërbimeve, Korçë	600	Blerje pajisje elektronike	114,900
5	Shkolla e Shërbimeve, Korçë	602	Mallra e shërbime, Kap. 6	81,990
	Totali i programit 09240			836,484

Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Inovacionit nëpër programet

Në kuadër të zbatimit të buxhetit për periudhën janar–prill 2026, Aparati i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit ka të planifikuara fonde në disa programe buxhetore, në varësi të rolit të tij administruar, koordinuar dhe zbatues. Këto fonde lidhen kryesisht me funksionimin

institucional, hartimin dhe koordinimin e akteve ligjore e nënligjore, administrimin e politikave sektoriale, ndjekjen e skemave mbështetëse, si dhe zbatimin e disa projekteve kapitale

Pjesa më e qartë e realizimit financiar të Aparatit evidentohet në programin 01110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, ku janë realizuar shpenzime për paga, sigurime, mallra e shërbime dhe disa zëra të tjerë funksionimi. Në programin 04130 “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik”, realizimi lidhet kryesisht me TVSH-në për projektet me financim të huaj. Në programin 09240 “Arsimi i Mesëm Profesional”, fondet e Aparatit përfshijnë bursa, akte ligjore/nënligjore, inspektive, TVSH dhe projekte kapitale të administruara në nivel qendror. Ndërsa në programet 06190 “Strehimi”, 01150 “Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji”, 10220 “Sigurimet Shoqërore” dhe 10550 “Tregu i Punës”, fondet e Aparatit janë kryesisht në fazë administrimi, ndjekjeje procedurale ose nuk kanë reflektuar ende realizim financiar të konsiderueshëm gjatë periudhës raportuese.

Në tërësi, realizimi i ulët në disa zëra lidhet me natyrën e fondeve të Aparatit, ku një pjesë e konsiderueshme janë projekte investimi, fonde të ngrira, TVSH për projekte me financim të huaj, bursa apo skema që reflektohen financiarisht në periudhat pasuese, pas përfundimit të procedurave përkatëse dhe paraqitjes së dokumentacionit për likuidim.

Programi	Emërtimi i programit	Natyra e fondeve të Aparatit	Plani / fondet e evidentuara në Aparat	Shpenzime faktike të periudhës	Komenti përmblledhës
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Paga, sigurime, mallra dhe shërbime, transferata, rikonstrukcion, pajisje TIK, automjete dhe fond i ngrirë	569,848,000	169,821,279	Ky është programi kryesor i funksionimit administrativ të Aparatit. Realizimi lidhet kryesisht me shpenzimet korrente, ndërsa në investime ka realizim të kufizuar dhe obligime të krijuara për automjete.
01150	Mbështetje për Inovacion dhe Teknologji	Akte ligjore/nënligjore, staf i trajnuar dhe fond i ngrirë për investime	65,440,000	0	Fondet lidhen me mbështetjen administrative të politikave të inovacionit dhe me fondin e ngrirë për investime, i cili është në proces ndjekjeje procedurale.
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	Akte ligjore/nënligjore dhe TVSH për projekte me financim të huaj	54,813,000	11,196,531	Realizimi i Aparatit në këtë program lidhet kryesisht me likuidimin e TVSH-së për projekte me financim të huaj.
06190	Strehimi	Bonus qiraje, subvencionim qiraje, grant i menjëhershëm dhe investime për projekte të strehimit social	755,000,000	0	Fondet lidhen me skemat sociale të strehimit dhe investimet që realizohen në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Realizimi pritet të reflektohet pas dokumentacionit dhe situacioneve nga bashkitë dhe rialokimi i fondit për to sipas procedurave.
09240	Arsimi i Mesëm Profesional	Akte ligjore/nënligjore, inspektive, bursa për nxënësit e AP, TVSH dhe projekte kapitale të administruara nga Aparati	Rreth 1,649,443,306	Rreth 11,479,380	Fondet lidhen me administrimin qendror të politikave të arsimit profesional, bursat, TVSH-në dhe projektet kapitale. Realizimi është i pjesshëm, ndërsa shumica e projekteve kapitale është ende në proces.
10220	Sigurimet Shoqërore	Vetëm zëra administrativë të Aparatit: paga, sigurime dhe mallra e shërbime	7,070,000	0	Në këtë përmblledhje nuk përfshihet transferata korrente e programit, pasi ajo nuk përfaqëson fond funksionimi të Aparatit. Janë marrë vetëm zërat administrativë të evidentuar në Aparat.
10550	Tregu i Punës	Akte ligjore/nënligjore, studim-projektim dhe bashkëfinancim me projektet IPA	94,251,500	0	Në këtë përmblledhje vlera përfaqëson fond funksionimi të Aparatit. Janë marrë vetëm zërat administrativë të evidentuar në Aparat. Per IPA do të vijojë me rialokime sipas procedurës dhe për studimim prjetik do ia koleht AKPA per ekzekutim.

Shënime metodologjike mbi përgatitjen e raportit

Gjatë përgatitjes së raportit të monitorimit për periudhën janar–prill 2026, janë marrë në konsideratë ndryshimet institucionale dhe buxhetore të ndodhura si rezultat i kalimit të disa programeve nga grupi buxhetor 12 në grupin buxhetor 04. Për këtë arsye, në anekset përkatëse janë kryer ndërhyrje manuale për rakordimin e të dhënave me Ministrinë e Financave, veçanërisht për pasqyrimin e faktit të vitit 2025 dhe krahasueshmërinë me strukturën aktuale të programeve buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Gjatë procesit të hartimit të raportit dhe anekseve shoqëruese, sistemi AFMIS ka shfaqur probleme teknike, të cilat kanë kufizuar aksesimin dhe përdorimin e tij në një periudhë vendimtare për përgatitjen e dokumentacionit të monitorimit. Për këtë arsye, raporti dhe anekset përkatëse nuk janë gjeneruar automatikisht nga sistemi AFMIS, por janë përgatitur manualisht, mbi bazën e të dhënave të disponueshme, informacionit të marrë nga institucionet dhe rakordimeve financiare të kryera nga strukturat përgjegjëse dhe nga sistemi SIFQ.

Në veçanti, Aneksi 3.2 dhe Aneksi 4 janë hartuar manualisht, në masën e mundur, duke marrë në konsideratë kufizimet teknike të sistemit, volumin e lartë të të dhënave, si dhe faktin që kodet e produkteve dhe projekteve rezultojnë të shpërndara në disa grupe buxhetore/ministrotre. Kjo shpërndarje ka vështirësuar përpunimin automatik të informacionit dhe gjenerimin e krahasimeve të plota dhe të sakta, pasi variancat e prodhuara automatikisht nuk do të reflektonin në mënyrë të plotë dhe reale ndryshimet institucionale dhe buxhetore të ndodhura.

Raporti është përgatitur mbi bazën e të dhënave të sistemit SIFQ, sipas gjendjes së fondeve në datën **08.05.2026**, pa përfshirë sistemimet, korrigjimet apo ndryshimet e kryera nga institucionet pas kësaj date. Për këtë arsye, të dhënat e paraqitura në raport pasqyrojnë gjendjen e rakorduar deri në datën e sipërpërmendur dhe mund të përditësohen në vijim, pas funksionalizimit të plotë të sistemit AFMIS dhe/ose pas përcjelljes së informacionit të përditësuar nga institucionet përgjegjëse.

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mbetet në pritje të njoftimit për rivendosjen në funksion të plotë të sistemit AFMIS, me qëllim përditësimin, verifikimin dhe, sipas rastit, rakordimin e mëtejshëm të të dhënave të monitorimit buxhetor.

Përfundimi dhe rekomandime

Për shkak të kufizimeve teknike të sistemit AFMIS gjatë periudhës së hartimit të raportit, të dhënat janë përpunuar manualisht mbi bazën e gjendjes së SIFQ në datën 08.05.2026 dhe rakordimeve të disponueshme, ndaj çdo sistemim i mëvonshëm nga institucionet zbatuese do të reflektohet në raportimet pasuese.